

# ENVER HOXHA,

## PËR SHQIPTARËT E MBETUR NËN PUSHTIMIN JUGOSLLAV



GJOKË DABAJ

**(Fragmente nga veprat)**

NËNTOR 2016

~~~~~

## **Parathënie**

Lexova kohët e fundit 3 libra voluminozë që i paraqesin Enverin dhe Kohën (Epokën) e Enverit ndryshe nga ç'ka qenë. Njëri prej tyre e paraqiste këtë prijës të Kombit tonë edhe si një "antikosovar të përbindshëm". Nuk po dua të

merrem tash me ata njerëz , të cilët, ose s'kanë logjikë të shëndoshë, ose e kanë nxjerrë në treg dhe e kanë shitur logjikën, bashkë me moralin. Por mendova që, gjithsesi, publikut i duhet ofruar e vërteta ashtu siç ka qenë. I vola këta fragmente nga vepra dhjetërvëllimëshe të Enverit, shkruar e publikuar prej kohësh, por e privuar me shumë mënyra prej syvet të lexuesit. Le t'i shohë dhe le të gjykojë vetë lexuesi.

Tri çështje, ose tre aspekte, duhet t'i kemi të qartë në analizën e asaj që, me të drejtë, është quajtur në historinë e shqiptarëve *Epoka e Enver Hoxhës*:

1. Fjalori që përdor Enver Hoxha, veçanërisht ai gjeografiko-politik, në mjaft raste, nuk ishte i saktë as për atë kohë; rrjedhimisht, ai i duhet nënshtruar një korrektimi të kujdesshëm në përshtatje me konceptet e kohës sonë.

2. Përkundër vlerësimit pozitiv të asaj epoke, në shumicën e përbërësve të saj, askush nuk duhet të pretendojë apo, edhe më keq, të kërkojë që ajo epokë të rikthehet në Shqipëri. Historia asnjëherë nuk përsëritet. Ajo zhvillohet në formën e spiraleve, herë duke ecur nëpër dritë e herë e zhytur në kaosin e mjegullavet dhe të errësirës.

3. SHBA-ja dhe Anglia duhet të marrin përgjegjësitë që u takojnë lidhur me faktin që Shqipëria mbeti e copëtuar edhe pas Luftës së Dytë dhe të ndërmarrin veprime konkrete për t'i korrigjuar rrënjësisht shkeljet që kanë bërë, në krejt historinë e Kohës së Re, në lidhje me Kombin Shqiptar. /Gj.D/

\*\*\*



Enver Hoxha, **vepra 1.**

+ (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr.16) Mizoritë që ngjanë në Kosovë e u kryen prej bandavet çetnike të Mihajllloviqit, në lidhje të ngushtë me fashizmin okupator, sikundër e tregon haptazi dokumenti me rëndësi që u tërhoq nga arkivat sekretë të fashizmit, hedhin një dritë të qartë në opinionin shqiptar, sqarojnë më së miri se ç’do të thotë “*Kosovë e çliruar*”, e trumbetuar nga fashizmi dhe hyzmeqarët e tij shqiptarë. (f.242-243)

+ (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr.16) Ne në këtë radhë do të përsërisim ato që ka thënë kurdoherë “*Zëri i Popullit*” përsa i përket luftës që bëhet sot, përsa i përket Shqipërisë, përsa i përket Kosovës. (f.243)

- + (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr.16) Në mes nesh e jugosllavëvet qëndron çështja e Kosovës, të cilën fashizmi po e përdor si mollë shërri për të përçarë unitetin e luftës që po i bëjmë të dy popujt, ai po e përdor Kosovën për të na hedhur në gjakderdhje me popullin jugosllav dhe ta lëmë të lirë fashizmin të na robërojë më mirë. (f.247)
- + (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr.16) Të gjithë e dimë, dhe s’ka kush e mohon, se shumica e banuesvet në Kosovë janë shqiptarë. (f.248)
- + (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr 16) Padrejtësi të turpshme janë bërë në kurrizin e popujvet. Aq sa ka vuajtur Kosova nga imperialistët sërbë, aq ka vuajtur edhe populli sërb, malazez, kroat, slloven, maqedon, boshnjak etj. Kosovarët shqiptarë e dinë mirë se tok me ta vuanin edhe malazezët, si dhe sërëbët e ndershëm të Kosovës, prej xhelatëve të krajlit Aleksandër.” (f.248)
- + (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr.16) Italia fashiste dhe hyzmeqarët shqiptarë bërtasin: “*Kosova u çlirua*”! Se sa u çlirua Kosova s’është nevoja të zgjatemi... Kosova është e çliruar sa ç’është e çliruar Shqipëria. (f.248)
- + (Mars 1943, “*Zëri i Popullit*” nr, 16) Çlirimin tonë do ta fitojmë me gjak, se s’na e dhuron kush; gjithashtu edhe Kosova. Lirinë e Kosovës nuk do ta fitoni ju, or politikanë të falimentuar, por do ta fitojë vetë populli i Kosovës, do ta fitojnë Asim Vokshët, Emin Durakët. Do ta fitojë lufta heroike e popullit të Kosovës, luftë e lidhur ngushtë me luftën heroike të popullit shqiptar, të popullit jugosllav, francez, grek, çekoslllovak etj., luftë e lidhur ngushtë me luftën titanike që bëjnë popujt e Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës. (f.251)
- + (4 tetor 1943, letër) Baca (Ramadan Çitaku, Gj.D.) më çon një letër nga Tempua për Komitetin Qendror. Kjo letër është shumë fyese për ne, dhe Tempua shkruan në një mënyrë aspak komuniste, duke na akuzuar si sabotatorë, se ne nuk kemi çuar ushtritë tona të shuajmë reaksionin në Maqedoni dhe Tempua të vendosë puhtetin. Ai paturpësisht akuzon Haxhi Lleshin. (f.457)
- + (4 tetor 1943, letër) Po i ruajmë të gjitha letrat e Tempos dhe tonat që i çojmë, dhe, në rastin më të parë, të gjitha do t’ia komunikojmë Titos, t’i gjykojë vetë mutësitrat e Tempos. (f.457)

+ (4 tetor 1943, letër) Traktet për Kosovën të shtypen dhe 4000 copë. Korrigjoni atje ku ju kam shënuar. Këto të katër mijët e tjera i korrigjoni me dorë. Mos i shpërndani në Tiranë, se janë për Kosovën. (f.463)

+ (29 tetor 1943, letër drejtuar Vukmanoviq Tempos) Letrat e tua na kanë çuditur së tepërmi; toni i tyre është shumë i ashpër dhe gjykimet e tu për Komitetin Qendror tonin nuk janë të drejtë. (f.508)

+ (29 tetor 1943, nga e njëjta letër Tempos) Me i quejtë shokët tanë sabotatorë dhe agjentë të Shqipërisë së Madhe, na duket se akuza është shumë e madhe dhe e guximshme. (f.508)

+ (29 tetor 1943, nga e njëjta letër Tempos) Kufijtë e rinj që ka caktuar fashizmi, ne nuk i pranojmë. (f.509)

+ (29 tetor 1943, nga e njëjta letër Tempos) Ne mendojmë se momenti nuk ishte i përshtatshëm (me forca të pakta që kemi ne) që të vendosej pushteti maqedonas në Dibër, sepse atëherë ne dhe ju do të kishim gjithë reaksionin në kurriz, dhe jo vetëm reaksionin, por edhe popullin, i cili do të na akuzonte si të shitur. (f.510)

## ENVER HOXHA, **vepra 6.**

+ (15 shtator 1949, në Shkodër) Titoja s'është veçse një kral i ri në shërbim të borgjezisë jugosllave dhe të imperialistëve... Janë po këta imperialistë që e copëtuan Shqipërinë dhe e kishin bërë monedhë shkëmbimi vite me radhë, që i shkëputën Shqipërisë Kosovën. (f.290)

+ (15 shtator 1949, në Shkodër) Krali Tito, haptas shkon me vendosmëri në rrugën e kral Aleksandrit dhe të Pashiqit, për të copëtuar Shqipërinë dhe për të shfarosur shqiptarët kosovarë. (f.294)

+ (15 shtator 1949, në Shkodër) Klika e Tito-Rankoviqit pushkatoi me qindra kosovarë në Kosovë dhe në Ulqin (në Tivar, Gj.D.), duke i akuzuar këta si reaksionarë. (f.295)

+ (15 shtator 1949, në Shkodër) Tradhtarët e dinë mirë se Kosova nuk mundet të bashkohet me Shqipërinë në rrugën e Mit'hat Frashërit, në rrugën e Titos dhe të imperializmit. As aleati i tyre Tito, nuk do t'ia japë kurrë Kosovën **Komitetit** të Mit'hat Frashërit, sepse ai do ta mbajë për vete Kosovën dhe ka bërë me kohë tratativa të fshehta me Caldarisin për të copëtuar Shqipërinë. (f.295)

+ (15 shtator 1949, në Shkodër) (Shqiptarët e Kosovës), tok me popujt e tjerë të Jugosllavisë, do të fitojnë lirinë dhe të drejtën e vetëvendosjes. (f.296)

### ENVER HOXHA, **vepra 9.**

+ (31 mars 1952, në Kongresin e Dytë të PPSH-së) ...Populli shqiptar i Kosovës e Metohisë, i Maqedonisë, i Malit të Zi, kundër të cilit klika e Beogradit po ushtron një terror të jashtzakonshëm, më të egër dhe më shfarosës se terrori i kralëvet. Banditët e Rankoviçit po vrasin, po burgosin, po internojnë me mijëra shqiptarë të Kosovës. Qëllimi i tyre është të zhdukin shqiptarët e Kosovës, t'i shkombëtarizojnë dhe t'u rrëmbejnë tokat, t'u zhdukin gjuhën shqipe, t'i kthejnë në turq, t'u prishin zakonet dhe, mbi të gjitha, të luftojnë në ta dashurinë për Shqipërinë, për atdheun e tyre. Terrori i klikës së Beogradit mbi kosovarët është një krim genocid. Populli shqiptar ngre zërin për të mbrojtur vëllezërit e tij në Kosovë, Metohi, Maqedoni e Mal të Zi dhe kërkon nga bota përparimtare që të ndalet dora kriminale e klikës së Beogradit që po shfaros shqiptarët e Kosovës. (f.149)

+ (31 mars 1952, në Kongresin e Dytë të PPSH-së) Shqiptarët e Kosovës së bashku e të vëllazëruar me popujt e Jugosllavisë, duhet t'u rezistojnë barbarizmave të xhelatëve të tyre, të luftojnë për lirinë e tyre. Kosovarët të ndjekin rrugën e Asim Vokshit, Bajram Currit, Emin Durakut, Xhevdet Dodës, Milladin Ppoviçit etj. kundër klikës së Beogradit, kundër Xhafer Devëvet, Kryezinjvet dhe tradhtarëve të çdo kallëpi, të cilët vazhdimisht kanë shkaktuar mjerimin e tyre. (f.149-150)

### ENVER HOXHA: **vepra 10.**

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) Krajlrat e Sërbisë e të Malit të Zi gjithmonë kanë dashur copëtimin e Shqipërisë. Ata për vite me radhë kanë shtypur e shfrytëzuar popullsinë shqiptare të Kosovës e të Metohisë dhe i kanë pasur sytë vazhdimisht në këtë anë të kufirit për të zgjeruar sundimin e tyre mbi tokat tona. (f.14)

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) Copëtimin e Shqipërisë e kanë synuar gjithmonë edhe fashistët e Athinës edhe të Romës. Për armiqtë që rrethojnë vendin tonë, Shqipëria ka qenë vazhdimisht një pre që ata turreshin për ta copëtuar. (f.14)

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) UDB-ashët e Rankoviçit po vrasin dhe terrorizojnë popullsinë shqiptare të Kosovës dhe Metohisë. Shqiptarët e Kosovës dhe të

Metohisë kanë hequr dhe po heqin nga bandat e Rankoviçit atë që nuk e kanë hequr as në regjimet e krajlavet. Mijëra gra, pleq e fëmijë janë shfarosur nga bandat e Rankoviçit që gjatë çlirimit të Kosovës e Metohisë nga pushtuesit fashistë. Shfarosja ka vazhduar sistematikisht edhe më vonë. (f.25-26)

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) Duke pakësuar numrin e shkollave shqipe dhe duke hapur në vend të tyre shkolla turke, ata përpiqen që, një mëngjes të bukur, t'i quajnë shqiptarët turq dhe, me një argument të tillë, t'i shpërngulin më në fund në Turqi. (f.26-27)

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) Bandat e Rankoviçit, me terror, me shpifje, me tortura, po bëjnë çmos që të futin gjithashtu edhe mosbesimin në mes të shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë, duke rekrutuar agjentë dhe spiunë nga llumi i shqiptarëve ... dhe kështu të krijohet mendimi se s'mund të rezistosh, s'mund të luftosh, s'ka kujt t'i besosh etj. (f.27)

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) Bashkëluftëtarët e patriotit të madh Bajram Curri, ... i mbajnë mend mirë fjalët e këtij burri të zgjuar, përparimtar e tejpamës, kur e pyetën lidhur me çlirimin e Shqipërisë dhe të Kosovës. Ata thonë se ai ishte përgjigjur: ***“Shqipëria dhe Kosova do të fitojnë lirinë, kur të fitojnë në këto anë idetë e profetit Lenin.”*** (f.28)

+ (8 shtator 1952, në Tropojë) Dhe fjalët e arta të plakut të pavdekshëm të Dragobisë u realizuan në Shqipëri. Shqipëria u çlirua pse triumfuan në botë dhe në vendin tonë idetë e të madhit Lenin. (f.28)

+ (11 shtator 1952, në Peshkopi) Shqiptarët e Kosovës e të Metohisë po i rezistojnë me trimëri regjimit të egër të Beogradit. (f.52)

+ (11 shtator 1952, në Peshkopi) Klika e Tito-Rankoviçit punon jo vetëm për shfarosjen e vëllezërvet tanë kosovarë, por nën urdhërat e imperialistëve amerikanë dhe anglezë bën plane kundër Republikës sonë Popullore. (f.52)

+ (9 korrik 1953, bisedë me dy pleq në Tropojë) Shpend Balija: ***“Enver, meqë po më pyet për ndonjë hall të popullit, po të them: Ka qenë një kosovar i quajtur Z.R. që rron në Qerret të Durrësit dhe e kanë ba kulak, prandaj këqyrja pak dertin.”*** Enver Hoxha: ***“Do të interesohem ta shohim.”*** Shpend Balija: ***“Edhe për një R.B. në Vaspas, që ka pasë mbajtë fshehun Bajram Currin, këqyrja dertin edhe atij,***

*se kur erdha këtu më tha fol edhe për mue ndonjë fjalë.” Enver Hoxha: “Do të interesohem t’i shohim dhe do të bëhet ç’të jetë e mundur më mirë.” (f.491)*

#### ENVER HOXHA, **vepra 14.**

+ (13 shkurt 1957, në një plenum të KQ) Partia jonë ka mbajtur dhe mban qëndrim të drejtë për çështjen e Kosovës... Por ne s’mund të mos vëmë në dukje qëndrimin shovinist të udhëheqjes jugosllave në Kosovë, për të vërtetuar edhe njëherë se ajo është në pozita antimarksiste dhe antinjerëzore kundrejt shqiptarëve të Kosovës. (f.283)

+ (1 mars 1957, në një aktiv të PPSH-së) (K.) Popoviqi na akuzon se kemi ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe këtë ata e shtrojnë pse ne kemi ngritur zërin për shqiptarët e Kosovës. Po, shokë, ne jemi interesuar dhe do të interesohemi akoma për shqiptarët e Kosovës, se ne e shohim që ata nuk po trajtohen mirë nga qeveria jugosllave, ata po i shpronësojnë duke i dërguar në Turqi dhe tokat po ua shesin serbëve. Ne kemi ndërhyrë dhe do të ndërhyjmë që të bëhet një politikë e drejtë shtetërore, t’u përcaktohen të gjitha të drejtat kombëtare të jetës së lirë, të ndjenjave të tyre dhe të pushohet propaganda kundër tyre. (f.335-336)

#### ENVER HOXHA, **vepra 17.**

+ (6 maj 1959, disa çështje të historisë) Çështja e pasqyrimin të historisë së Kosovës pas 1912-s meriton një studim të veçantë. (f.181)

+ (28 shtator 1959, në Bica) Ne duhet të punojmë edhe kundër propagandës së revizionistëve të cilët arrijnë deri atje sa të nxjerrin njerëz buzë kufirit dhe të bërtasin se fshatarët në Jufosllavi gjoja hanë bukë të bardhë, kanë kinema, shtëpi kulturore etj. ...Po fshatarët tanë kanë bërë përparime më të mëdhenj në karahasim me ata të Kosovës, Metohisë dhe të Maqedonisë që vuajnë dhe kanë mungesa të mëdha. (f.313)

+ (“Zëri i popullit”, 31 tetor 1959) Shtypi jugosllav e veçanërisht agjencia Tanjug, bëjnë zhurmë të madhe për “*përparimet*” e krahinave autonome në Jugosllavi e sidomos për Kosovën. Me sa duket gjendja me të vërtetë e mjeruashme ekonomike e kulturore e popullit të Kosovës dhe reagimi i opinionit publik i ka shtërnguar drejtuesit revizionistë të Beogradit, në mos të bëjnë gjë, së paku të bëjnë zhurmë se



po bëjnë diçka për fatin e atij populli të mjerë e të shtypur. Për këtë qëllim sajohen “*plane shoqërorë*” për qarkun e Kosovës e të Metohisë, dërgohen atje në vizita të shkurtëra dhe për të mbajtur fjalime të gjatë gjithfarë Veselinovër, Miniqër, Peneziçër e Baboviçër. (f.362)

+ (“Zëri i popullit”, 31 tetor 1959) Por as planet shoqërorë e shtetërorë, as vizitat e këtyre “*miqve*” të padëshiruar nuk po ia përmirësojnë gjendjen popullit të vuajtur të Kosovës (f.362)

+ (“Zëri i popullit”, 31 tetor 1959) Sipas revizionistëve jugosllavë, Partinë e Punës të Shqipërisë e paska themeluar Partia Komuniste Jugosllave! Me këtë pretendim, sa absurd aq edhe idiot, revizionistët jugosllavë bien në të njëjtat pozita dhe përsëritin të njëjtin “*lajtmotiv*” të armiqvet të popullit shqiptar, të fashistëve, ballistëve, zogistëve, se Partinë tonë heroike e kanë themeluar të huajt. (f.362-363)

### ENVER HOXHA, **vepra 18.**

+ (25 prill 1960, takim me ushtarakë dhe me forca të kufirit) Imperialistët e kanë pasë copëtuar vendin tonë. Kur u caktuan kufijtë e sotëm të Shqipërisë, atëherë në botë sundonte plotësisht imperializmi... Në këta kushte, ...toka të gjëra të atdheut tonë mbetën jashtë këtyre kufijve, ...shumë pjesë të kufijvet të sotëm u caktuan sipas interesit të imperialistëve dhe jo në bazë të kufijvet etnikë, për të lënë brenda kufijvet të gjithë trojet që i përkisnin me të drejtë popullit tonë. (f.205)

+ (13 shkurt 1961, Kongresi IV i PPSH-së) Tragjedia e popullsisë shqiptare që jeton në Jugosllavi, është e njohur nga të gjithë. Partia jonë ka ngritur dhe do ta ngrëjë zërin e saj kundër ndjekjevet, shpërnguljevet të shqiptarëve në Turqi dhe kundër gjithë politikës shoviniste shfarosëse, që ndiqet në Jugosllavi (ndaj) vëllezërvet tanë shqiptarë të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Rrafshit të Dukagjinit. (f.111)

### ENVER HOXHA, **vepra 21.**

+ (2 maj 1961, *Rankoviqi në Athinë*) Puna e komplotëve jugosllavë dhe grekë për copëtimin e Shqipërisë ka rrënjë të vjetra. ... (Për shembull), bisedimi Tito-Pavel në Korfuz më 1956-n, për ta ndarë Shqipërinë midis Jugosllavisë e Greqisë. ... (Por), me gjithë aleancën e ngushtë, ...nuk mungojnë të dalin në sipërfaqe (edhe

mosmarrëveshjet). Kështu, në gushtin dhe dhjetorin e vitit që shkoi, disa gazeta greke dhe jugosllave nisën një fushatë të ashpër për punën e Maqedonisë. ...Janë të gjitha mundësitë që, të dyja palët, të mbeten të kënaqura duke e zgjidhur këtë çështje në kurriz të Shqipërisë. ... (Lidhur me idenë greke të Vorio-Epirit) Rankoviqi do t'i japë (grekut) pa tjetër eksperiencën jugosllave mbi "*autonominë e Kosovës*" (f.14-15)

#### ENVER HOXHA, **vepra 24.**

+ (26 nëntor 1962, në vigjilje të Festavet të Nëntorit) Këto dy ngjarje historike neve na kujtojnë luftërat legjendare të popullit shqiptar që nga shekujt e kaluar e gjer në ditët e sotme, luftërat e pandërprera kundër armiqvet të shumtë,...që kishin për qëllim copëtimin e Shqipërisë. ... (Me këtë rast) patriotët e mëdhenj, Ismail Qemali, Bajram Curri dhe Selam Musai, të nderohen me dekoratën më të lartë të Republikës "*Hero i Popullit*" (f.2,4)

+ (29 Nëntor 1962, në pritje me rastin e Festavet) Në një moment shumë kritik, për të siguruar lirinë dhe unitetin territorial të vendit dhe si përgjigje kundër komplotit të Kongresit të Berlinit, u organizua më 1878 Lidhja Shqiptare e Prizrenit, me Abdyl Frashërin në krye. (f.11)

+ (29 Nëntor 1962, në pritjen me rastin e Festavet) Të paharruara do të mbeten betejat legjendare të shqiptarëve që, për 3 vjet me radhë, mbrojtën me gjoks Plavën e Gucinë, Hotin, Grudën e Ulqinin, duke u bërë kështu një sfidë të pashembullt fuqivet perendimore. (f.11)

+ (29 Nëntor 1962, në pritjen me rastin e Festavet) Shovunistët sërbo-malazezë ...i masakruan e i robëruan kosovarët dhe (e) copëtuan Shqipërinë. (f.13)

+ (29 Nëntor 1962, në pritjen me rastin e Festavet) Në pranverë të vitit 1912 (kryengritjet) shndërrohen në lëvizje të fuqishme të armatosur, të udhëhequr nga patriotët e mëdhenj, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Themistokli Gërmenji etj. (f.14)

#### ENVER HOXHA, **vepra 29.**

+ (7 shkurt 1965, mbi “*vetadministrimin*” jugosllav) Gazeta “*Borba*” e 30 tetorit 1963 është e detyruar të pohojë, ndër të tjera, se në Kosovë e Metohi ka sot 43 643 veta pa asnjë mjet jetese. (f.33)

### ENVER HOXHA, **vepra 33.**

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Krimet e gjenocidit që janë zbatuar kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Mal të Zi, janë produkt i politikës së nacionalizmit e të shovinizmit të egër që ka zbatuar regjimi titist. (f.257)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Ne i kemi të gjitha të drejtat të ngremë zërin tonë për të mbrojtur interesat jetikë të popullsisë shqiptare në Jugosllavi. (f.259)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Krimet, vrasjet e asgjësimi fizik i popullsisë shqiptare në Jugosllavi nga ana e klikës titiste, si dhe politika për shkombëtarizimin e saj, përbëjnë një vijë sistematike, e cila ka filluar qysh në ditët e para të çlirimit dhe ka vazhduar me egërsi gjithnjë e më të llahtarshme edhe sot e kësaj dite. (f.258)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Kurrë nuk do të harrojë popullsia shqiptare në Jugosllavi ngjarjen e hidhur të vjeshtës 1944, kur banda Tito-Rankoviq arrestoi në Tetovë 10000 shqiptarë dhe pushkatoi pa gjyq 1200 prej tyre. (f.259)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Në nëntorin e vitit 1944 mijëra fshatarë të pafajshëm shqiptarë u pushkatuan rrugëvet të Maqedonisë, u dogjën në zjarr, u infektuan me qëllim dhe vdiqën nga tifoja. (f.259)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Mbi 2000 shqiptarë në Mitrovicë, më se 1000 të tjerë në Gjilan, mijëra shqiptarë që shkuan si partizanë në brigadat jugosllave për të luftuar fashistët, u vranë me plumb pas kokës, me urdhër të shtabit jugosllav. (f.260)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Qindra shqiptarë të tjerë të rekrutuar ushtarë nga jugosllavët, u pushkatuan prej tyre gjatë rrugës Prizren-Tivar. 1200

djem shqiptarë që kishin mbetur nga ky udhëtim tragjik, u pushkatuan në Tivar. (f.260)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Në Gorica të Triestes më shumë se 2000 djem shqiptarë nga Maqedonia, të mobilizuar në brigada pune, u mbytën me gaze helmues. (f.260)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Nga të dhënat e dëshmitarëve e të dokumenteve, del se më shumë se 4000 vetë (të tjerë, përveç atyre që përmenden, Gj.D.) kanë rënë pabesisht nga plumbi, bajoneta dhe helmi i agjunkturës titiste gjatë viteve 1944-1948. (f.260)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) A mund të shprehen me fjalë dhe të përshkruhen krimet dhe barbarizmat e pashembullt që klika titiste kreu në dimrin e viteve 1955-1956, kundër popullsisë shqiptare gjatë të ashtuquajturit *aksion i armëve*? Për zbatimin me përpikëri të operacionit kriminal dhe për drejtimin e ekspeditave ndëshkimore, Titoja ngarkoi vetë Rankoviçin, formoi edhe një shtab në të cilin ishin caktuar njerëzit më të sprovuar në barbarizma, shovinistë nga më të tërbuarit, kriminelë të regjur, që kanë lyer duart me gjakun e popullit shqiptar të Kosovës. Ky shtab udhëhoq nga Dushan Mugosha, Gjoko Pajkoviç, koloneli i UDB-ës Çedo Mijoviç, Çedo Topaloviç, Xhavit Nimani, Xhevdet Hamza. (f.261)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Drejtori i burgut të Sremit ishte i njohur si çetnik dhe profesionist për vrasje e tortura. Në të tillë burgje vuajnë persekutimet më të egër, shkrimtari patriot kosovar Adem Demaçi dhe qindra patriotë të tjerë, të cilët... nuk i janë nënshtruar dhe nuk do t'i nënshtrohen kurrë zgjedhës së Titos, dhunës shfarosëse, diskriminimit nacional e gjenocidit. (f.265)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Deri tani, sipas pohimeve të shtypit, janë detyruar të braktisin vendlindjen e tyre për në Turqi më tepër se 250000 shqiptarë. (f.269)

+ (31 gusht 1966, *Kush përgjigjet për krimet...*) Rajone të tërë shqiptarësh, të cilët janë nën administrimin e Malit të Zi e të Maqedonisë, si Ulqini, Tivari, Plava, Gucia, Tutini, Rozhaja, Ohri, nuk kanë shkolla shqipe. (f.270)

ENVER HOXHA, **vepra 35.**

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Josip Broz Titoja... zbriti për një vizitë të shkurtër në krahinën më të shqetësuar të mbretërisë së tij, në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit.. në Mitrovicë e Prishtinë, në Prizren e Gjakovë, në Pejë e Zveçan. (f.207)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Kosova është vendi ku është zbatuar në mënyrën më radikale, më të egër dhe me mjete më barbarë, politika shoviniste e revizionistëve jugosllavë ndaj një kombësie të madhe, siç është ajo shqiptare. (f.208)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Kohët e fundit, jo se nuk diheshin, por titistët u detyruan të pranoin vetë publikisht krimet e rëndë të genocidit, që ata kanë bërë kundër shqiptarëve. (f.210)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Por Titoja nuk foli fare për këto ngjarje. (Përkundrazi, ai tha në Mitrovicë): “*Nuk duhet që shqiptarët, të cilët janë këtu të shumtët, të shikojnë prapa*”. (f.211)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Titoja... me sa duket, kërkon të likuidojë krejtësisht edhe atë autonomi të vogël të kësaj krahine, ... kërkon të krijojë kushte edhe më të padurueshëm politikë e ekonomikë, që shqiptarët të braktisin tokat e tyre, që në Kosovë të vërshojnë sërëbët e malazeztë, që gjuha shqipe, zakonet shqiptarë, traditat e ndjenjat, fizionomia shqiptare e popullsisë së saj të eliminohet në çdo mënyrë. (f.213)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Ndonëse udhëtimi i Titos në Kosovë kishte një karakter të theksuar antishqiptar, ai nuk guxoi të zinte hapur në gojë komunistët shqiptarë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë, nga frika e kosovarëve, të cilët i njohin mirë faktet dhe politikën e drejtë të Partisë e të shtetit tonë. (f.215)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Në Gjakovë... sot punon një njeri në çdo 11 vetë, nga gjithsej 22000 banorë të komunës së Gjakovës. (f.218)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Ai po mundohet tani që forca punëtore e paangazhuar në punë, që është krejtësisht shqiptare, të largohet nga krahina, duke emigruar, ose jashtë shtetit, si në Gjermaninë Perendimore, në Vendet Skandinave, në Francë, në Zvicër etj., ose në republikat e veriut, të cilat kanë nevojë për krahë pune. (f.219)

+ (5 prill 1967, Titoja në Koosvë) Me këtë metodë, që nuk është më pak barbare nga ajo e përdorur pak vjet më përpara, kur shqiptarët e Kosovës e të Maqedonisë i shpërngulën me forcë për në Turqi, klika titiste kërkon t'u heqë krahinavet shqiptare brezat e rinj. (f.219)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Por cila është gjendja në fushën e arsimit e të kulturës në Kosovë? Autoritetet jugosllavë thonë se akoma 40 për qind e popullsisë është analfabete. (f.220)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Titoja tha se në territorin e Kosovës nxirret 6 për qind e energjisë elektrike e të gjithë Jugosllavisë, 8 për qind e prodhimit të qymyrgurit, 50 për qind e plumbit të pastër, 30 për qind e magneziumit, 90 për qind e argjendit etj., pa përmendur prodhimin e madh bujqësor. (f.220)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Por fëmijët kosovarë nuk kanë asnjë kasolle të thjeshtë, ku të mësojnë abetaren dhe janë detyruar të mbeten përjetë analfabetë. (f.220)

+ (5 prill 1967, Titoja në Kosovë) Gjuha shqipe në Kosovë nuk është e nuk do të jetë kurrë një çështje thjeshtë linguistike, por problem jetik, për të cilën kosovarët luftojnë pa u përkulur për ta vënë në vendin që meriton. (f.222)

### ENVER HOXHA, **vepra 36.**

+ (3 shtator 1967, fjalim në Shkodër) Kosovarët, vëllezërit tanë nga gjaku, nga shpirti e nga traditat, nuk po e pranojnë shtypjen titiste jugosllave. Jo! Ata lëvizin dhe qëndrojnë si kurdoherë kreshnikë. Populli i Kosovës, ndërsa urren klikën tradhtare të Titos, ushqen një dashuri të madhe për atdheun e tij, për gjuhën dhe zakonet e vet, për vatrat dhe tokën e tij, për një jetë më të mirë, prandaj nuk mund të pajtohet në asnjë mënyrë me shtypjen titiste. (f.260)

### ENVER HOXHA, **vepra 37.**

+ (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Ka disa muaj që klika e Titos ka shpërthyer një fushatë të gjërë demagogjike e mashtruese në drejtim të Kosovës dhe të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, duke bërë gjithfarë premtimesh false e lajkash dinake. Sunduesit e Beogradit hiqen tani sikur po duan t'i korrigojnë gabimet shovinistë të Rankoviqit. (f.66)

- + (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Hiqen sikur u vjen keq për Kosovën dhe se duan „*të korrigjojnë*“ disa nga gabimet që atje paska bërë Rankoviçi dhe që Titoja nuk i „*dinte*“. (f.74)
- + (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Popullsia e Kosovës (si krahinë autonome, Gj.D.) përbën 5,1 për qind të popullsisë së Jugosllavisë, por krahinës së Kosovës i kanë caktuar vetëm 1,2 për qind të konsumit buxhetor. (f.74-75)
- + (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Vlen të shtojmë ndërkaq se tani në Kosovë mungojnë 2400 arsimtarë. Edhe prej atyre që tani punojnë në arsim 70 për qind janë të pakualifikuar. (f.75)
- + (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Shumë më keq është gjendja e shqiptarëve në Maqedoni e sidomos në Mal të Zi, ku atyre u janë mohuar edhe të drejtat më elementare kombëtare, ku ndiqet një politikë e egër barbare për shkombëtarizimin e tyre. (f.75)
- + (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Popullsia shqiptare, që jeton në Mal të Zi, në Ulqin, në rrethet e Liqenit të Shkodrës, në Tuz, në Plavë dhe Guci etj., nuk ka jo më një gazetë në gjuhën shqipe, por as (edhe) një buletin informativ, pa përmendur faktin që atë e detyrojnë me forcë të ndjekë shkollat serbe. (f.78)
- + (16 tetor 1967, *Demagogjia titiste*) Titoja dhe banda e tij janë përgjegjës për masakrën e Drenicës, për vrasjen e mijëra e mijëra të rinjvet shqiptarë në rrugën Prizren-Ulqin, për mbytjen e mijëra shqiptarëve në kampet e përqëndrimit të Shkupit, të Tetovës, të Prishtinës, të Mitrovicës etj. (f.79)
- + (16 tetor 1967, *Demagogjia e Titos*) Shqipëria nuk i harron kurrë, por ka nderuar e nderon patriotët kosovarë, që kanë luftuar gjatë historisë për lirinë dhe pavarësinë e plotë të Shqipërisë. (f.81)
- + (17 prill 1968, *Terrorizimi i popullit shqiptar...*) Në fund të muajit të kaluar autoritetet jugosllavë organizuan në Manastir një proces gjyqësor kundër një grupi fshatarësh të ashtuquajtur agjentë të shërbimit të Republikës Popullore të Shqipërisë. (f.508)
- + (17 prill 1968, *Terrorizimi i popullit shqiptar...*) Fshatarët analfabetë nga rrethi i Strugës u akuzuan se gjoja kishin vendosur që “*rajoni i Kosovës dhe i Metohisë*

*dhe Maqedonia Perendimore të bashkohen me Shqipërinë me anë të përdorimit të forcës*". Me të vërtetë të fortë këta fshatarë! (f.508)

+ (17 prill 1968, *Terrorizimi i popullit shqiptar...*) Procesi gjyqësor i Manastirit, ashtu si edhe ata të mëparshmit të kësaj kategorie, është një shprehje e politikës antishqiptare e thellësisht armiqësore që rregjimi i Beogradit ka ndjekur gjatë këtyre 24 vjetëve kundër vendit tonë. (f.510)

+ (17 prill 1968, *Terrorizimi i popullit shqiptar...*) Disa përpjekje të elementit shqiptar në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi për të ruajtur e për të zhvilluar kulturën e traditat kombëtare, titistët i kanë shpallur gati si "*mina*" që do të hedhin në erë gjithë Jugosllavinë. (f.511)

### ENVER HOXHA, **vepra 39.**

+ (17 dhjetor 1968, bisedë me Sali Bruçajn) E.Hoxha: "*Nëna e Ismetit nga është?*" S.Bruçaj: "*Nga Gucia. Është fejuar me mua që kur isha 19 vjeç.*" E.Hoxha: "*Vëllezërit tanë kosovarë janë njerëz seriozë, ata nuk flasin shumë, më parë mendojnë dhe mendojnë thellë, pastaj flasin dhe veprojnë. E kanë ata këtë karakteristikë, po kanë edhe veti të tjera të çmuara, si trimërinë, besnikërinë, patriotizmin e pashuar dhe dashurinë e zjarrtë për Shqipërinë... Akti heroik i Ismetit do të bëjë përshtypje të madhe edhe në Kosovë, ku populli, siç e ka treguar historia, nuk u është nënshtruar kurrë, shtypjes, skllavërisë, torturavet e vrasjevet të vazhdueshme, qoftë më parë prej kralëve dhe klikavet sërbo-mëdha, edhe tash së fundi prej klikës titiste.*" (f.387)

+ (17 dhjetor 1968, bisedë me Sali Bruçajn) "*Deshën nuk deshën revizionistët titistë, ua njohën kosovarëve të drejtën e flamurit. Flamuri ngjall, zhvillon e mban të ndezur vazhdimisht ndjenjat kombëtare. Tani në Kosovë populli, në çdo festë, deri edhe në raste martesash, do ta vërë para shtëpisë flamurin shqiptar me shkabën me dy krerë dhe me yll.*" (f.388)

+ (17 dhjetor 1968, bisedë me Sali Bruçajn) "*Kosovarët e kanë të qartë se sërbo-mëdhenjtë nuk do t'ua japin kurrë lirinë, se liria fitohet me luftëra, me përpjekje e me sakrifica.*" (f.388)

+ (17 dhjetor 1968, bisedë me Sali Bruçajn) „*Titistët janë frikësuar që, në Prishtinë dhe në katër-pesë qytete të tjerë të Kosovës, janë bërë demonstrata të mëdha, në të*



*cilat rinia ka dalë në rrugë, në mënyrë paqësore, me flamurin shqiptar përpara, duke kënduar këngë kombëtare.*“ (f.389)

#### ENVER HOXHA, **vepra 41.**

+ (28 qershor 1969, *Terrori rankoviqjan*) Po bëhen disa muaj që në Maqedoni ka shpërthyer një inkuizicion i vërtetë ndaj popullsisë shqiptare. Gjyqet po bëjnë kërدينë, jepen dënime mbi dënime, bëhen shpifje e sulme gjithfarësh antishqiptarë. (f.316)

+ (28 qershor 1969, *Terrori rankoviqjan*) Që nga fillimi i këtij viti e deri sot janë zhvilluar 13 gjyqe dhe janë gjykuar e janë dënuar mbi 170 vetë. (f.316)

+ (28 qershor 1969, *Terrori rankoviqjan*) Shqiptarët e dënuar akuzohen se kanë ngritur flamurin shqiptar dhe ky veprim, sipas ruajtësve të „drejtësisë“ në Maqedoni, përbëka një krim të pafalshëm. (f.317)

+ (28 qershor 1969, *Terrori rankoviqjan*) Duke persekutuar shqiptarët, rankoviqjanët maqedonas mos po bëjnë vallë lojën e tjetërkujt? (f.320)

#### ENVER HOXHA, **vepra 42.**

+ (22 nëntor 1969, bisedë me Olimbi Myshkerin) Ulqinakët kanë qenë detarët më të shquar në vendin tonë... Me varkat e tyre me vela ulqinakët shkonin tej përtej Adriatikut, nuk trembeshin, ata ishin luftëtarë të vërtetë të detit. (f.100)

+ (9 dhjetor 1969, bisedë me grup mërgimtarësh) Një nga qendrat më të lavdishme shqiptare për liri e pavarësi ka qenë edhe Kosova heroike e martire. (f.250)

+ (9 dhjetor 1969, bisedë me grup mërgimtarësh) (Presidentin Uillson) e heqin si babain e demokracisë, por pikërisht në kohën e tij nënshkruheshin traktatet e fshehtë për të copëtuar Shqipërinë dhe për këtë shkak një milion e gjysmë shqiptarë po vuajnë prej një kohe të gjatë në robëri, jashtë kufijvet shtetërorë. (f.254)

+ (9 dhjetor 1969, bisedë me grup mërgimtarësh) Ne me Jugosllavinë patëm marrëdhënie miqësore derisa Titoja qëndronte i maskuar, por edhe kur ai nuk ishte demaskuar akoma, i patëm thënë se ne nuk i harrojmë vëllezërit kosovarë, pse ata janë gjaku ynë. (f.255)

+ (9 dhjetor 1969, bisedë me grup mërgimtarësh) Në qoftë se Titoja paska të drejtë të interesohet për padrejtësitë që i bëhen një qytetari jugosllav, qoftë edhe në një skutë të SHBA-së, të Australisë etj., si nuk paskemi ne të drejtë të interesohemi për të drejtat e një milion e gjysmë vëllezërvet tanë, bija dhe bij të një nëne, në Kosovë?! (f.255)

+ (9 dhjetor 1969, bisedë me grup mërgimtarësh) Këtë shokun (Rexhep Durakun, Gj.D.) e kemi një patriot të shquar nga Kosova, nga vëllezërit tanë heroikë që rrojnë e luftojnë në Jugosllavi. Populli kosovar, siç e dini, nuk ndahet nga Shqipëria në sa ndahet mishi nga thoi. (f.272)

### ENVER HOXHA, **vepra 43.**

+ (27 maj 1970, *T'i kuptojmë politikisht çështjet*) Titoja, nga halli e jo nga malli, ka filluar tash t'u bëjë disa lëshime shqiptarëvet. Kohët e fundit shqiptarët në Jugosllavi kanë fituar të drejtën të ngrenë flamurin shqiptar, u mëkëmb Universitetit i Prishtinës, i cili na ka kërkuar që t'i ndihmojmë me tekste...na kanë bërë kërkesa për të shkuar pedagogë tanët atje për të mbajtur leksione për shqiptarët. Kjo është një gjë shumë mirë. (f.238)

+ (27 maj 1970, *T'i kuptojmë politikisht çështjet*) Rankoviçi me Titon dhe me dijeninë e plotë të tij u ka bërë gjithato të zeza shqiptarëvet të Kosovës. Mirëpo tani, meqenëse Rankoviçi u demaskua, Titoja tërë fajin ia hodhi atij. (f.239)

+ (27 maj 1970, *T'i kuptojmë politikisht çështjet*) Ai përpiket të tregojë sikur gjoja ka qenë kurdoherë në favor të shqiptarëvet dhe këtë e bën, që të shmangë telashet në situatat e vështira ku ndodhet, pse e di që shqiptarët janë të gishtit. (f.239)

+ (28 maj 1970, në Kukës) Gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, anekënd Shqipërisë dhe matanë kufijvet, ku jetojnë vëllezërit tanë, si ata në Kosovë e të tjerë, kanë luftuar e kanë derdhur gjak për të shpëtuar nga robëria e të huajvet, për të jetuar në unitet të plotë, ashtu siç e meriton një komb si yni. (f.296)

+ (30 maj 1970, në Bajram Curr) (Partizanët e Tropojës) luftuan heroikisht bashkë me partizanët e tjerë për çlirimin e gjithë krahinës, gjer në Gjakovë, në Pejë, në Prizren e thellë në Jugosllavi. Vëllezërit tanë kosovarë panë me sytë e tyre se si u shkuan në ndihmë për çlirimin nga pushtuesit nazifashistë bijat e bijtë e Bajram Currit e të Partisë Komuniste Shqiptare. (f.356)

+ (30 maj 1970, në Bajram Curr) Kemi plotësisht të drejtë të denoncojmë çdo veprim që u mohon vëllezërvet tanë kosovarë e të tjerëvet të drejtat që u jep kushtetuta jugosllave dhe çdo masë që synon shkombëtarizimin e tyre ose largimin nga toka e të parëvet. (f.374)

+ (30 maj 1970, në Bajram Curr) Populli shqiptar gëzohet... që populli, rinia dhe inteligjenca e Kosovës ndjekin shkollat shqipe dhe bëjnë përpjekje të mëdha për të forcuar e për të zhvilluar gjuhën, traditat, zakonet dhe kulturën shqiptare. (f.375)

+ (30 maj 1970, në Bajram Curr) Fakultetet e ndryshëm të universitetit tonë dhe institutet e tjerë të lartë janë gati të ndihmojnë vëllezërit kosovarë me tekstet e nevojshëm të lëndëvet të ndyshme. (f.375)

+ (30 maj 1970, në Kom. e Part. në Bajram Curr) Kosovarët kanë të drejtë të kërkojnë që të mos i marrin vetëm ushtarë të thjeshtë, se ata kanë dëshirë dhe aftësi të bëhen edhe oficerë, të komandojnë në ushtri edhe ata e jo vetëm sërbi e malazezi. (f.401)

+ (30 maj 1970, në Kom. e Part. në Bajram Curr) Kur të dalin oficerë, shumë nga ata do të kërkojnë me siguri që të mos i dërgojnë... në Slloveni, po edhe në Kosovë, pse me vëllezërit kosovarë që flasin të njëjtën gjuhë, do të merren vesh më mirë e s' do të lënë të merret Kosova nëpër këmbë. Kështu kërkesa do të lindë kërkesën. (f.401)

+ (31 maj 1970, në Bajram Curr) Qeveria e Beogradit duhet t'u japë të gjitha të drejtat vëllezërvet tanë të Kosovës, sepse shqiptarin askush, asnjë kral, sado i madh e i fortë që të jetë, nuk e mban dot në pranga dhe nuk mund ta mposhtë. (f.444)

#### ENVER HOXHA, **vepra 44.**

+ (3 gusht 1970, me *Alfatahun*) Të gjithë shtetet fqinjë, të mbështetur në fuqitë e mëdha të asaj kohe: Anglia, Gjermania, Franca, Rusia etj., u vërsulën ta copëtojnë vendin tonë. Në Konferencën e Ambasadorëvet, të mbajtur në Londër më 1913, kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë, sërbit na shkëputën Kosovën, copë e madhe e shumë pjellore e truallit tonë që edhe sot vazhdojnë ta kenë nën sundimin e tyre. Mali i Zi, gjithashtu, na rrëmbeu një pjesë të tokavet tona. (f.60)

+ (3 gusht 1970, me *Alfatahun*) Një nga diplomatët e kohës tha atëherë se cari i Rusisë po do t'i vërë zjarrin Evropës për të fërguar omëletën e knjaz Nikollës. (f.60)

+ (3 gusht 1970, me *Alfatahun*) Shqiptarët që jetojnë në atdheun e tyre të lirë, nuk mund të mos mendojnë për vëllezërit e tyre në Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni që padrejtësia e së kaluarës i ka lënë jashtë kufijvet shtetërorë shqiptarë. (f.66)

+ (6 tetor 1970, bisedë me grup kooperativistësh) Ajdin Bajraktari: *“Me ne është edhe vajza e Ali Shabanit. Ja ku është!”* Enver Hoxha: *“Oh, sa mirë! Si jeni, si është baba, a është mirë me shëndet? Kur isha me shokët në Dragobi, aty ku ishim ulur e po bisedonim, Aliu u interesua të dinte çfarë po bëhet tej kufirit dhe më tregoi Kosovën. Unë me këtë rast i fola për Kosovën, se e kuptova ku e kish hallin. Ai më dëgjonte me vëmendje.”* (f.314)

### ENVER HOXHA, **vepra 46.**

+ (24 prill 1971, me aviatorët) Tani Titoja është në pozita jashtzakonisht të vështira politike, ideologjike dhe ekonomike. Jugosllavia është në dekompozim si shtet. (f.81)

+ (24 prill 1971, me aviatorët) Titoja... përpiket t’i ketë nga ana e vet shqiptarët e Kosovës, sepse e njeh kokën e shqiptarit. Shqiptarët e Kosovës janë kundër sërbbomëdhënjet, sepse vazhdimisht u ka kulluar gjaku rrëke nga mizoritë e tyre. (f.82)

+ (24 prill 1971, me aviatorët) Rezistenca e inteligjencës shqiptare në Jugosllavi tash ka marrë një formë të zhvilluar, ajo po i mbron me guxim gjuhën e kulturën shqiptare. Intelektualët patriotë kosovarë shkruajnë në shtyp, i presin jashtzakonisht mirë, si vëllezër, ata që dërgojmë ne për të dhënë mësim, bile shumë prej tyre, kur takohen me njerëzit tanë, qajnë nga gëzimi. Kur shfaqen filmat shqiptarë, sallat e kinemavet të Kosovës mbushen sa s’ka ku të vejë. (f.83)

+ (7 maj 1971, në Elbasan) Situata që u krijua është shumë e favorshme për ne, kjo na jep mundësinë të forcojmë lidhjet me shqiptarët e Kosovës. (f.172)

+ (7 maj 1971, në Elbasan) Në kryeqytetin e Jugosllavisë janë thirrur nga Titoja e Kardeli udhëheqësit e partisë titiste dhe të pushtetit të krahinës autonome të Kosovës, të cilëvet u kanë thënë për sa kishin dëgjuar për Universitetin e Prishtinës, sikur ky qenka zaptuar nga Tirana. Ata u dhanë përgjigje se një gjë e tillë nuk ishte e vërtetë, u raportuan se profesorët e pedagogët e dërguar nga Tirana jo vetëm që janë njerëz shumë të kualifikuar, por edhe me sjellje jashtzakonisht

korrekte në çdo drejtim; u thanë se informatat ua kishin servirur ata që nuk ua duan të mirën Kosovës dhe shqiptarëvet. Titoja u detyrua të deklaronte sikur kishte mbetur i qartë përse i raportuan gjatë këtij takimi. (f.173)

+ (7 maj 1971, në Elbasan) Reaksioni sërb në fuqi, për të mos folur për atë që vepron nga jashtë, është i egër, i hapët, kundër shqiptarëvet. Sërbët përpiqen që kushtetuta të mos ua japë të gjitha të drejtat shqiptarëvet (të krahinës së Kosovës, Gj.D.)..., që kjo krahinë, kështu në letër, të quhet “*autonome*”, por të vazhdojë si më parë e edhe më keq pas vdekjes së Titos, të lëngojë nën terrorin sërbomadh. (f.179)

+ (7 maj 1971, në Elbasan) Gjithë shqiptarët që jetojnë nën robërinë titiste jugosllave mund të arrijnë afërsisht 1500000 veta, tri herë më shumë se malazezët, më shumë se sllovenët e se maqedonasit. (f.179)

+ (1 korrik 1971, *Atdheu është i gjithë popullit*) Ne nuk e kemi fshehur dhe nuk e fshehim nga kurrkush, se shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, i duam me gjithë shpirt, pse janë vëllezërit dhe motrat tona të një gjaku, të një gjuhe edhe të një mëme, që valët e egra të historisë i kanë shkëputur nga trangu. Ne, si marksistë-leninistë dhe si shqiptarë, ashtu si deri tash, edhe në të ardhmen, do të luftojmë kundër të gjithë atyre që do të orvaten t’i çkombëtarizojnë dhe t’i shtypin shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, do t’i përkrahim në kërkesat e tyre që të fitojnë të gjitha të drejtat që u përkasin brenda kushtetutës së Jugosllavisë. Ne e kemi për detyrë t’i ndihmojmë ata, veçanërisht në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare me një frymëzim të madh patriotik. (f.382)

#### ENVER HOXHA, **vepra 47.**

+ (13 tetor 1971, bisedë me Bije Vokshin) Enver Hoxha: “*Ç’ nuk ka bërë Jugosllavia, po s’na bën dot gjë. Ne jemi të fortë. Po të mos jesh i fortë, të marrin nëpër këmbë të tjerët.*” Bije Vokshi: “*Pleqtë e moçëm në Kosovë veç popullin e Shqipnisë mendojnë... Gjithmonë ne kemi luftue, po nuk kemi pasë udhëheqës, ashtu sikur dite Ti për me udhëheqë popullin shqiptar... Njeriun asht kollaj me e njoftë në luftë, se në luftë asht: ja vdekë, ja gjallë. Enveri i u jepte kurajë partizanëvet për me dalë malit. I kanë pushkatue partizanët dhe nuk e kanë qitë shokun.*” (f.73)

#### ENVER HOXHA, **vepra 49.**

+ (27 qershor 1972, me Norodom Sihanukun) Pëtej kufijvet tanë, në Lindje e në Veri, ekziston një popullsi e madhe shqiptare, si rezultat i Traktatit të Londrës... Fakti që atje janë rreth dy milionë shqiptarë, të cilët shtypen egërsisht, vërteton më së miri se udhëheqësit jugosllavë nuk janë në pozita të drejta... Pas Çlirimit unë shkova vetë në Beograd, u takova me Titon dhe, në një rast, duke biseduar, ai më bëri pyetjen: “*Çfarë mendon ti, shoku Enver, për Kosovën?*” Unë iu përgjigja: “*Megenë se më kërkoni mendim, po ju them se Kosova e vise të tjerë ku banojnë shqiptarë, janë toka shqiptare dhe si të tilla i përkasin dhe duhet t’i kthehen Shqipërisë. Ekzistenca e tyre jashtë kufijvet të atdheut përbën një padrejtësi të madhe që i është bërë Shqipërisë nga fuqitë e mëdha e që duhet ndrequr. Ne jemi dy vende socialistë dhe kushtet që kjo çështje të zgjidhet drejt tashmë ekzistojnë.*” “*Jam dakord, edhe ne këtë dëshirojmë*”, tha Titoja, duke u munduar të argumentonte se ishte e vështirë që shqiptarët të bashkoheshin menjëherë me atdheun e tyre. “*Vetëm, gjersa të zgjidhet kjo çështje*”, vazhdova unë, “*kërkojmë që shqiptarët të trajtohen si gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, të kenë njëlloj si ata shkolla ku të përdoret gjuha e tyre amtare dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat e tjera.*” Në realitet ai nuk ishte dakord me mënyrën si e shtrova unë këtë problem. Ai donte që Shqipërinë ta bënte republikë të shtatë të Federatës Jugosllave. (f.227-228)

+ (13 tetor 1972, me kinezët) Fuqitë imperialiste me marrëveshjet që kanë nënshkruar në të kaluarën, e kanë copëtuar Shqipërinë, duke i shkëputur asaj gjysmën që sot ndodhet jashtë kufijvet të saj të sotëm shtetërorë. (f.389)

+ (25 nëntor 1972, me drejtuesit e Akademisë) Mbetëm shumë të entuziazmuar nga niveli i zhvillimit të *Kongresit të Drejtshkrimit* që porsa u dha fund punimevet... Më pëlqyen mjaft ... referatat që mbajtën në Kongres vëllezërit tanë të ardhur nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, pjesëmarrja e të cilëve në këtë ngjarje të madhe historike të përbashkët është një fitore për ne. Disa prej tyre, në referatat që mbajtën, kishin vënë, me shumë vend, citate të marra nga shkrimet e profesor doktor Aleksandër Xhuvanit, si ai, për shembull, ku thuhet se “*Njësia e gjuhës është njësia e kombit*”. (f.495-496)

+ (20 nëntor 1972, *Ditari politik*) *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe* është një ngjarje me rëndësi historike për njësimin e drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare. Janë bërë përgjithësime shumë të rëndësishëm, që do ta zbukurojnë dhe do ta çojnë

më tej drejt përparimit gjuhën tonë, këtë thesar të madh, të pashterrshëm dhe gjithnjë në rritje e në zhvillim të popullit tonë. .. Profesori kosovar, Idriz Ajeti, luftëtar i shquar i mbrojtjes e i përhapjes dhe më në fund i vendosjes së gjuhës letrare shqipe në Kosovë, foli shumë mirë. Kumtesa e tij ishte e dokumentuar. (f.496)

+ (29 Nëntor 1972, në familjen e Sherif Hasanit) Mësuesit janë njerëz të respektuar në vendin tonë, sepse ata përhapin dijen e kulturën në masat e popullit. Sot në Kosovë e në Dibër ata po kryejnë një mision fisnik për mbajtjen gjallë e të pastër gjuhën amtare, që është thesari më i madh i kombit. (f.540)

### ENVER HOXHA, **vepra 50.**

+ (26 shkurt 1973, *Historia Luftës NÇ...*) Unë dhe shokët e mi nuk jemi dakord me arsyetimin, sipas të cilit teksti është i historisë së shqiptarëve, prandaj të flitet në të edhe për historinë e Kosovës e të Çamërisë. Ky mendim nuk më duket i drejtë... Të flitet për bashkëpunimin e çetave partizane të Shqipërisë së Veriut me çetat e para të Kosovës dhe të Maqedonisë... Është fakt historik i pamohueshëm që njësi të mëdha të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare e ndoqën pushtuesin gjerman edhe në Kosovë, prandaj luftimet tanë në Jugosllavi duhet t'i përshkruajmë mirë. (f.282-283)

+ (26 shkurt 1973, *Historia e Luftës NÇ...*) Në kuadrin e bashkëpunimit me Luftën Nacionalçlirimtare të popujvet të Jugosllavisë,... ne kemi ndikuar në zhvillimin me sukses të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë. (f.283)

### ENVER HOXHA, **vepra 52.**

+ (16 tetor 1973, me grupet folklorikë) Desha të thosha dy fjalë edhe për vëllezërit tanë të zemrës, kosovarët që jetojnë këtu, me ne. Me këngët e vallet e tyre ata shprehin forcën e madhe të karakterit, patriotizmin e madh, traditat e mëdha të luftërave për liri, të revolucioneve që ka zhvilluar ky popull, vëlla në shpirt e në gjak, kundër të huajvet, armiqtë të Shqipërisë. Këta vëllezër janë këtu, në vendin e tyre, në atdheun e tyre dhe ndërtojnë socializmin. Folklori i tyre karakteristik dhe shumë i bukur nuk është veçse folklori ynë, i Shqipërisë. (f.198)

+ (20 mars 1974, me veteranët e *Luftës NÇ*) Partia i edukoi veteranët si internacionalistë dhe këtë e treguan me vepra... Ata dolën edhe jashtë kufijvet të Shqipërisë dhe luftuan me trimëri e vetëmohim edhe për çlirimin e popujvet të Jugosllavisë, për çlirimin e vëllezërvet shqiptarë të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, që të jetonin të lirë në trojet e tyre të lashtë. (f.321)

### ENVER HOXHA, **vepra 53.**

+ (17 dhjetor 1974, në analizën e komplotit të ushtarakëvet) Lidhjet me Jugosllavinë nuk na sollën asgjë të mirë, veç të këqjavet. (f.471)

### ENVER HOXHA, **vepra 54.**

+ (1 prill 1975, shënime) Si mund të ekzistojë... barazi, kur Kosova me popullsi shqiptare shtypet e gjakoset dhe shqiptarëvet në Jugosllavi nuk u jepeshin e nuk u jepen nga titistët të drejtat e tyre kombëtare dhe demokratike? (f.310)

+ (1 prill 1975, shënime) Lënia pas dore nga ana kulturore e Kosovës nga funksionarët serbë, dëbimi i shqiptarëvet nga tokat e tyre për në Turqi, nuk tregojnë veçse atë që asgjë nuk kishte ndryshuar në mendjen e shovinizmit serb titist. (f.310-311)

+ (1 prill 1975, shënime) Një nga personat që i shtypte kosovarët dhe që i gjakosi, ishte Dushan Mugosha, kurse një nga ata që i mbronte, ishte Milladin Popoviqi. Borgjezia titiste, të parin e bëri "*hero të popujvet të Jugosllavisë*", të dytin "*natën*" e vrau me atentat, "*ditën*" e bëri hero. (f.311)

+ (1 prill 1975, shënime) Procesin e zhvillimit të Jugosllavisë duhet ta kemi vazhdmisht në vëzhgim të rreptë. (f.311)

+ (1 prill 1975, shënime, sqarim në fusnotë) (Dushan Mugosha) erdhi në Shqipëri në verën e vitit 1941. Siç u vërtetua më pas, ishte i ngarkuar nga udhëheqja jugosllave për të zhvilluar punë agjenturore në radhët e komunistëvet shqiptarë e të PKSH-së. Në pranverën e vitit 1943 rekrutoi si agjent të jugosllavëvet Mehmet Shehun, të cilin e nxiti që të kryente akte terrorizmi e gabime të rëndë sektarë me qëllim që të përgatitej terreni për shtrembërimin e vijës së drejtë të PKSH-së, për goditjen e nënshtrimin e udhëheqjes së saj. (f.311)



(Pohimi që Dushan Mugosha ishte një armik e shovinist ndaj shqiptarëve, është i saktë, ndërsa çfarë thuhet për Mehmet Shehun, duhet të merret me rezerva dhe t'i lihet historiografisë për ta gjykuar. Gj.D.)

+ (1 prill 1975, shënime, sqarim në fusnotë) (Milladin Popoviqi) komunist internacionalist jugosllav, i cili u lirua nga komunistët shqiptarë në vjeshtë të vitit 1941 nga një kamp përqëndrimi fashist në Shqipëri. Qëndroi në Shqipëri për të mbajtur lidhje midis PKSH-së dhe PKJ-së dhe përkrahu qëndrimin internacionalist të PKSH-së. Në shtator të vitit 1944, me urdhër të udhëheqjes së LKJ-së, u largua nga Shqipëria dhe, në mars të vitit 1945, u vra me atentat të kurdisur nga shërbimi i fshehtë jugosllav. (f.311)

+ (21 maj 1975, *Të forcojmë ndërgjegjen...*) Me revizionistët jugosllavë jemi armiq, por nuk jemi aspak të tillë me popujt e Jugosllavisë, dhe veçanërisht me vëllezërit tanë kosovarë. Regjimi titist i ushqen me ideologjinë e vet armiqësore popujt që ka nën sundim. Nga ky rrëzik nuk kanë shpëtuar as kosovarët. Ka më shumë se tri dekada që armiku propagandon me të gjitha format dhe mjetet idetë e tija reaksionare... Mbrojtja e atdheut jo vetëm nga agresioni ushtarak, por edhe nga diversioni ideologjik e politik është çështje patriotike. (393)

+ (21 maj 1975, *Të forcojmë ndërgjegjen...*) Kur vjen babai, motra apo vëllai nga Kosova ose Dibra e Madhe, të përpiqemi t'i sqarojmë për realitetin tonë, për politikën e drejtë që bën Partia jonë dhe për perspektivat që kemi përpara, t'u bëjmë të njohur sukseset e ndërtimit të socializmit në Shqipëri, t'u tregojmë pikëpamjet tona të drejta marksiste-leniniste për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore. (f.393-394)

+ (21 maj 1975, *Të forcojmë ndërgjegjen...*) Dashuria dhe respekti për vëllanë dhe motrën që jetojnë larg nesh, të ruhen... Ata që vijnë në Shqipëri të priten me ngrohtësi si motër a vëlla. Për çdo gjë që është nevoja, të afërmit tanë që jetojnë larg atdheut, t'i sqarojmë pa ekzagjerime. T'u themi atyre: "***Shikoni vetë fushat, ndërmarrjet bujqësore, shkollat, spitalet, fabrikat... Në vendin tonë ndihma mjekësore sigurohet falas, tatimet e taksat janë hequr, çdo fshat është elektrifikuar.***" (f.394)

ENVER HOXHA, **vepra 57.**

+ (Prill-maj 1976, probleme të gjendjes ndërkombëtare) Partia jonë, si parti e vërtetë marksiste-leniniste, ka mbajtur kurdoherë qëndrime të drejtë përsa u përket vëllezërvet tanë shqiptarë që jetojnë në tokat e tyre, në Jugosllavi. Janë të kota dhe shumë të dëmshme orvatjet e autoriteteve jugosllavë për të armiqësuar shqiptarët e Jugosllavisë me Republikën Popullore të Shqipërisë. (f.234)

+ (Prill-maj 1976, probleme të gjendjes ndërkombëtare) (Ky) është një realitet i pamohueshëm i Shqipërisë socialiste, që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste. Nëse e pëlqejnë shqiptarët e Jugosllavisë këtë realitet, as ne, as shteti jugosllav nuk mund ta pengojë. (f.234)

+ (Prill-maj 1976, probleme të gjendjes ndërkombëtare) Fjalime të tillë, si ata të Miniqit e të ndonjë tjetri, me siguri që do t'i acarojnë ndjenjat e shqiptarëve që banojnë në Jugosllavi. (f.234)

+ (Prill-maj 1976, probleme të gjendjes ndërkombëtare) Këto që themi ne, shovinistët jugosllavë mund t'i quajnë ndërhyrje në punët e brendshme të tyre nga ana jonë. Por kjo nuk është aspak e vërtetë. Ata që pretendojnë aq shumë se janë "*komunistë*", le t'i kthehen historisë së hidhur e grabitqare të reaksionit sërbo-madh dhe do të shikojnë se kush ka ndërhyrë në punët e njëri-tjetrit dhe kush i ka shkaktuar fatkeqësi tjetrit. (f.235)

+ (Prill-maj 1976, probleme të gjendjes ndërkombëtare) Ne, kur ka qenë rasti, pa frikë nga kurrkush, i kemi mbrojtur vëllezërit shqiptarë të Jugosllavisë nga të këqiat e mëdha që u janë bërë atyre në kohën e Rankoviçit. ...Popullsia shqiptare e Jugosllavisë ka të drejtën të gëzojë të gjitha liritë dhe avantazhet që gëzojnë atje edhe popujt e tjerë. (f.235)

### ENVER HOXHA, **vepra 58.**

+ (23 shtator 1976, *Të qëndrojmë në pozitë tona*) Ne mbajmë qëndrim ndaj revizionistëve të Beogradit, por flasim edhe për çështjen e Kosovës. Qëndrimet që mbajnë tani udhëheqësit jugosllavë ndaj Kosovës nuk janë të hapët, si në kohën e Rankoviçit. Megjithatë, me metoda dhe forma të tjera të reja, titistët përpiqen t'i persekutojnë kosovarët, t'i përçajnë, t'i shkombëtarizojnë dhe Kosovën ta varfërojnë. Marrëdhëniet reciproke që janë vendosur aktualisht midis Shqipërisë dhe Kosovës, nuk i kanë dashur kurrë revizionistët titistë jugosllavë. (f.233)

+ (23 shtator 1976, *Të qëndrojmë në pozitë tona*) Gjatë momenteve të vështirë që kaloi regjimi i titizmit, kohët e fundit titistët u detyruan t'i zbutin qëndrimet e mëparshëm me Kosovën dhe i dhanë asaj disa të drejta... Tani përpiqen dhe jo vetëm përpiqen, por edhe marrin masa për t'i frenuar këta lëshime dhe bëjnë çmos që t'i diskreditojnë kosovarët. Ata udhëheqës shqiptarë kosovarë që janë agjentë të titistëve, bëjnë sulme të drejtpërdrejta kundër popullit patriot kosovar. (f.233)

### ENVER HOXHA, **vepra 59.**

+ (1 nëntor 1976, Kongresi VII i PPSH-së) Partia jonë, si një parti e vërtetë marksiste-leniniste, ka mbajtur kurdoherë qëndrime të drejtë për sa u përket vëllezërvet tanë shqiptarë që jetojnë në tokat e tyre, në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Janë të kota dhe shumë të dëmshme orvatjet që bëhen nga disa autoritete jugosllavë për të armiqësuar shqiptarët e Jugosllavisë me Republikën Popullore të Shqipërisë. (f.227)

+ (1 nëntor 1976, Kongresi VII i PPSH-së) Lidhjet vëllazërore të gjakut e të gjuhës me shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, lidhjet e traditës dhe të zakonevet kombëtarë na japin të drejtën, pa ndërhyrë në punët e brendshme të shtetit jugosllav dhe duke respektuar normat ndërkombëtare, të interesohemi që ata të gëzojnë të gjitha të drejtat, liritë dhe avantazhet që kanë edhe popujt e tjerë të Federatës Jugosllave. (f.227-228)

+ (1 nëntor 1976, Kongresi VII i PPSH-së) Këtu nuk është fjala për ndonjë kooperativë bujqësore në Shqipëri, që ka popullsi maqedonase e gëzon të gjitha të drejtat sipas Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë (Banorët e fshatit Pustec, Gj.D.) dhe as për ndonjë minoritet të paqenë malazez në Shqipëri, siç pretendon propaganda jugosllave (Banorët e fshatit Vrakë, Gj.D.), bëhet fjalë për më se 1 milion e 500 mijë shqiptarë. (f.228)

+ (13 nëntor 1976, *Një artikull flluskë sapuni i Borbës*) Për sa i përket çështjes së shqiptarëve që banojnë në trojet e vet në Jugosllavi, titistët përpiqen që fjalët tona t'i kthejnë në favorin e tyre. Mirëpo kjo është një propagandë e qepur me pe të bardhë, që nuk gënjen asnjëri që i njeh mirë këto çështje e, në radhë të parë, nuk i gënjen shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjerë në Jugosllavi. (f.355-356)

+ (13 nëntor 1976, *Një artikull fluskë sapuni i Borbës*) Shqiptarët atje kanë disa të drejta formale por, në të vërtetë, atje sundon ligji i sërbo-mëdhenjvet, sundon ligji i “*vetadministrimit*” që e ka rrjepur Kosovën, të cilën e ka lënë të varfër, të mjeruar, ligj ky që i shtyn kosovarët të largohen nga tokat e tyre dhe të shkojnë në kurbet si krahë pune të thjeshtë e për të lënë atje kockat, (ose të) bredhin rrugëvet të Jugosllavisë për të çarë dru e për të shitur salep. (f.356)

+ (14 nëntor 1976, shënime lidhur me vizitën e pritshme të Brezhnjevrit në Bukuresht e Beograd) I themi haptazi qeverisë jugosllave se nuk do të lejojmë që në kufijtë tanë shtetërorë të afrohen forcat agresive revizioniste sovjetike. (f.367)

+ (14 nëntor 1976, shënime lidhur me vizitën e pritshme të Brezhnjevrit në Bukuresht e Beograd) Shqipëria Socialiste dhe shqiptarët e tjerë, kudo ku ata banojnë, dhe këtu e kam fjalën për në Jugosllavi, nuk do të lejojnë më si në kohët e kaluara të bëhen monedhë tregu e fuqivet të mëdha imperialiste dhe e qeverivet reaksionare fqinje. Jo, ato kohë kanë kaluar dhe nuk do të përsëriten më. (f.367)

+ (14 nëntor 1976, shënime lidhur me vizitën e pritshme të Brezhnjevrit në Bukuresht e Beograd) Ne nuk dëshirojmë luftë, por, në qoftë se do të fillojnë përsëri luftërat ballkanike, imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe forcat reaksionare të vendeve fqinjë, të jenë sigurt se nuk do të luajnë më me fatin e popullit shqiptar. Këto luftëra nuk do të përfundojnë më në favorin e tyre si më parë, por në favorin e popullit shqiptar. (f.367)

+ (14 nëntor 1976, shënime lidhur me vizitën e pritshme të Brezhnjevrit në Bukuresht e Beograd) Në rast se popujt e Jugosllavisë e lënë veten të shkelen, të shtypen, të pushtohen dhe nuk do të luftojnë, atëherë populli shqiptar, kudo që është, do të dijë të mbrojë veten e tij... Në këtë mënyrë populli shqiptar (do të ndihmojë) edhe në mospërhapjen e një lufte të madhe të tretë botërore. Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë... synojnë me masa konkrete ta përgatitin dhe ta realizojnë luftën e tretë botërore dhe ta hedhin botën në zjarr. (f.368)

+ (14 nëntor 1976, shënime lidhur me vizitën e pritshme të Brezhnjevrit në Bukuresht e Beograd) Bullgarët e sovjetikët duhet ta dinë se në Jugosllavi banojnë shqiptarë... dhe ata janë të paprekshëm. Tash ata rrojnë tok me popujt e Jugosllavisë, por kur një i tretë hyn e pushton Jugosllavinë, të jenë të sigurt se shqiptarët do të nrenë krye. Vetëm në Maqedoni rrojnë më tepër se 400 mijë shqiptarë dhe, në rast se dikush sulmon

nëpërmjet Maqedonisë Jugosllavinë, shqiptarët do të marrin pushkën e do t'u bëjnë ballë hordhivet pushtuese të Brezhnjevitet ose të cilitdo tjetër dhe do të mbrojnë kufijtë e tokave të tyre me gjak, se atdheu i tyre nuk do të shkelet aq lehtë. (f.369)

+ (14 nëntor 1976, shënime lidhur me vizitën e pritshme të Brezhnjevitet në Bukuresht e Beograd) Atdheun tonë ne do ta mbrojmë, tokat e shqiptarëve, në rast se të tjerët nuk i mbrojnë, por i braktisin, ne do t'i mbrojmë, vëllezërit tanë ne do t'i mbrojmë, në qoftë se jugosllavët nuk ngrenë pushkët, në qoftë se ulin kokën si çekoslovakët para pushtuesve sovjetikë. (f.369)

+ (25 nëntor 1976, bisedë me Zhoao Amazonasin) Në Jugosllavi ka më shumë se 2 milionë shqiptarë. Kur perandoria turke po copëtohej, në Shqipëri plasi kryengritja, qendra e së cilës ishte në Kosovë. Udhëheqësit e lëvizjes kombëtare shqiptare u mblodhën në Prizren dhe, për të mbrojtur interesat kombëtarë të Shqipërisë, krijuan Lidhjen e Prizrenit... Lidhja e Prizrenit organizoi dhe udhëhoqi kryengritjen, e cila u shtyp me gjak... (Fuqitë e mëdha), nëpërmjet traktateve të hapët e të fshehtë që nënshkruan, e ndanë Shqipërinë, pjesën më të madhe të saj ua dhanë Serbisë e fqinjëve të tjerë. (f.396)

+ (25 nëntor 1976, bisedë me Zhoao Amazonasin) Shqiptarët në Jugosllavi kanë jetuar e vazhdojnë të jetojnë të robëruar e pa liri. Për vite me radhë ata janë persekutuar e janë shpërngulur me forcë nga Kosova në Turqi, ku kanë qenë të detyruar të fllenë jashtë, nëpër sheshe e në xhami. (f.396-397)

+ (25 nëntor 1976, bisedë me Zhoao Amazonasin) Në vitin 1946 ne biseduam me Titon për çështjen e Kosovës. Unë i shpreha mendimin se Kosova dhe viset e tjerë të banuar nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen kësaj. (f.397)

+ (25 nëntor 1976, bisedë me Zhoao Amazonasin) Kur në Jugosllavi u acarua gjendja e brendshme dhe u ashpërsua lufta për pushtet me klanin serbomadhi, Titoja, që është një akrobat i madh politik, duke parë situatën e vështirë, për të manovruar më mirë, i bëri disa "*lëshime*" edhe popullit shqiptar të Kosovës dhe gjithë fajin për persekutimet ndaj tij ia hodhi Rankoviqit. Por vetë populli i Kosovës e pa se cili ishte qëllimi i vërtetë i "*lëshimeve*" dhe i premtimeve të Titos. (f.397)

**ENVER HOXHA, vepra 61.**

+ (6 prill 1977, *Idetë e Rilindjes...*) Tendanca e historiografisë zyrtare jugosllave është që karakterin e vërtetë dhe objektivat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit t'i lërë në mjegull ose të kalojë vetëm në çështjen e Rilindjes. Ne nuk duhet të biem në këtë gabim. Rilindja ka luajtur një rol me rëndësi vendimtare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare, por mbledhja që u bë më 1878 në Prizren, nuk është e tërë Rilindja, as kurorëzimi i saj, siç duan të thonë disa. Jo. Lidhja Shqiptare e Prizrenit është pjesë e Rilindjes, një nga kulmet e saj, por në asnjë mënyrë e tërë Rilindja. (f.149)

+ (6 prill 1977, *Idetë e Rilindjes...*) Nuk duhet të kuptohet sikur Lidhja Shqiptare e Prizrenit është një ngjarje e lidhur vetëm me popullin shqiptar të Kosovës. Qëllimet dhe lufta e saj ishin çështje jetike për gjithë Shqipërinë. (f.149)

+ (6 prill 1977, *Idetë e Rilindjes...*) Ne duhet t'i kundërvihemi historiografisë jugosllave, e cila nuk (dëshiron) ta interpretojë drejt këtë ngjarje të rëndësishme. Kjo është e kuptueshme. Historianët e regjimit titist jugosllav, shovinizmi serb dhe elementët që i shërbejnë atij aktualisht, as janë në gjendje, as kanë predispozicionin ta trajtojnë këtë ngjarje historike në vërtetësinë e saj. (f.149-150)

+ (6 prill 1977, *Idetë e Rilindjes...*) Njëkohësisht ne... duhet të... mendojmë edhe për shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, të cilët të shikojnë me këtë rast metodën dhe stilin e analizave marksiste-leniniste për të tilla çështje të rëndësishme, por edhe ekzistencën e tyre si komb, si pjesë e kombit shqiptar, të shikojmë luftërat e tyre në unitet me gjithë shqiptarët për një Shqipëri të lirë e të pavarur, kurdoherë në kuadrin e asaj periudhe. (f.154)

+ (23 maj 1977, *Shkenca etnografike...*) Ta bëni këtë gjë për vendin tonë, për historinë e popullit tonë dhe, kur them për vendin tonë, kam parasysh edhe vëllezërit tanë kosovarë. Duhet ta dinë mirë kosovarët historinë e vendit të tyre, të trajtuar në mënyrë marksiste-leniniste, pa i pëlqeka apo nuk i pëlqeka kjo dikujt, neve aq na bën. (f.236)

+ (23 maj 1977, *Shkenca etnografike...*) Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk u bë për të hedhur valle, as për t'u përfaquar me sërbo-mëdhenjtë. (f.236)

+ (23 maj 1977, *Shkenca etnografike...*) Aleks Buda: "***Kjo është fotografia ku ju keni dalë në Dragobi.***" Enver Hoxha: "***Kjo fotografi është bërë atëherë kur kemi***

*shkuar në Valbonë. Ai plaku me të cilin bisedoj, është një patriot i vjetër, shok i Bajram Currit. Pikërisht në momentin që na ka kapur aparati fotografik, ai, duke treguar tokat matanë kufirit, më tha: Ja, edhe andej nga ajo anë e kishte zemrën trimi Bajram, për të mbrojtur shqiptarët e Malit të Zi që persekutoheshin nga kral Nikolla.”* (f.238)

+ (23 maj 1977, *Shkenca etnografike...*) Dritëro Agolli: „*Me sa më kujtohet, shoku Enver, ai iu tha atëherë që “po të ndodhë ndonjë gjë, menjëherë merr flakë stralli.”* Enver Hoxha: “*Po,po. Unë i thashë atij plakut të Alpevet se si luftojnë kosovarët për gjuhën, zakonet dhe të drejtat e tyre edhe plaku u gëzua shumë.”* (f.238)

#### ENVER HOXHA, **vepra 62.**

+ (18 nëntor 1977, *Të mos e ndalim luftën*) Udhëheqësit kinezë... ngritën çështjen e “*rregullimit*” të të gjithë kufijvet në Evropë... Mao Ce Duni foli... për kufijtë e Polonisë, të Rumanisë e të Çekosllovakisë, por “*harroi*” të zinte në gojë edhe kufijtë e Shqipërisë, “*harroi*” Kosovën, që fuqitë imperialiste ia rrëmbyen Shqipërisë dhe ia falën Jugosllavisë. Sot pasuesit e Maos po propagandojnë me zell të ashtuquajturit suksese të Kosovës, në një kohë që edhe vetë shtypi jugosllav nuk e fsheh dot prapambetjen e madhe të kësaj krahine. (f.449-450)

#### ENVER HOXHA, **vepra 64.**

+ (17 mars 1978, fjalim në Gjirokastrë) Shqiptarët që banojnë në Jugosllavi, janë shumë të shtypur, por nuk e kanë humbur ndjenjën e atdhedashurisë. Ata përpiqen të shfrytëzojnë disa të drejta që janë shpallur në kushtetutën e Jugosllavisë. Ne nuk përzihemi në punët e brendshme të këtij vendi, por kemi kërkuar e vazhdojmë të kërkojmë që vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi të gëzojnë të gjitha të drejtat kushtetuese, që ata të mos diskriminohen e të mos shtypen, të mos u mbyllen shkollat shqipe e të mos u prishen zakonet. Këto të drejta ne do t’i mbrojmë ngaherë, se nuk kemi frikë t’u dalim zot vëllezërve tanë. (f.99)

+ (18 mars 1978, *Karakteret kombëtar të artit*) Edhe në Kosovë... është pëlqyer interpretimi i këngëtarëve dhe i valltarëve tanë popullorë. Kur kanë shkuar ansamblet tanë në Kosovë, njerëzit e shumtë nuk gjenin bileta të hynin në shfaqje,

edhe se autoritetet ua kishin shpërndarë ftesat njerëzvet të tyre. Popullit ata gati nuk i shitën fare bileta. (f.195)

+ (20 mars 1978, *Traditat patriotike*) Njerëzit tanë herë vishnin opinga lëkure në këmbë, po shumë herë ecnin edhe zbathur e me nga një gunë të çjerrë e një llabane mbi kokë; por “*Maliherin*” dhe “*Mauzerin*” s’i lëshonin nga dora, ato kurdoherë u këndonin si bilbil. Ata ndoqën rrugën e luftëtarëve të shquar të gjithë Shqipërisë, edhe të luftëtarëve nga Kosova, e cila sot është ndarë nga Shqipëria. (f.234)

+ (20 mars 1978, *Traditat patriotike*) Abdyli ishte politikan e organizator i madh... E ku nuk ka vajtur! Në të katër anët e Shqipërisë, në të katër anët e Kosovës, për ta bërë të lirë, për të flakur tej zgjedhën e otomanit, për të shpëtuar Shqipërinë nga copëtimi, nga lakmia e shovinistëve të sërbe, malazezë e grekë. (f.235)

+ (22 mars 1978, bisedë në Dropull me minoritarët greqishtfolës) Nuk po ju flas gjatë për Jugosllavinë, ku shqiptarët që jetojnë në trojet e vet janë persekutuar e janë vrarë mizorisht. Atje edhe sot e kësaj dite janë gjetur rrugë e mjete „*demokratikë*“ për t’i sikterisur kosovarët, për t’i dërguar në Turqi e gjetkë, larg truallit të tyre. Kosovarët kanë emigruar në gjithë Evropën. Në këto rrethana është e kotë të flitet për barazi në të drejtat që gjoja ata kanë me kombësitë e tjera. (f.338)

+ (22 mars 1978, bisedë në Dropull me minoritarët greqishtfolës) Raportin në mbledhjen e kryesisë së Komitetit Krahinor të Kosovës, që „*drejtohej*“ nga një shqiptar, e mbajti Petar Jakshiqi, i ardhur nga Sërbia, kurse raportin për ndryshimet në statut edhe për kuadrot, e mbajti Vojislav Popoviqi, edhe ky i ardhur nga Sërbia. Kësaj i thonë: Ti, shqiptar, mos fol, por „*mba tufën*“, siç tregojnë për Qaqen, që i thoshin: „*Mos fol ti, por mba tufën!*“ (f.339)

+ (27 mars 1978, bisedë në Sarandë) Dibranët, njerëzit e thjeshtë, janë patriotë të shquar, si për këtë ashtu edhe andej kufirit, shqiptarët e Dibrës së Madhe, të Tetovës, të Gostivarit... Lidhja Shqiptare e Prizrenit luftoi atëherë me vendosmëri e patriotizëm të madh për mbrojtjen e tokave tona nga copëtimi i fqinjëve. (f.458)

+ (27 mars 1978, bisedë në Sarandë) Nacionalistët e tërbuar sërbe, kanë mbajtur referate kundër kombit tonë që i lexonin në klubet e tyre, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sërbisë, në Universitetin e Beogradit ose në Institutin e Kombësive. Në këta referate shtrohej edhe problemi se ç’rrugë duhej të ndiqte



qeveria e Sërbisë për likudimin e popullsisë me kombësi shqiptare. Për këtë qëllim, si zgjidhje në këta shkrime armiqësorë rekomandoheshin: gjenocidi, vrasjet, nxitja e hakmarrjes, burgosja, dënimi me vdekje, krijimi i kushtevet për t'ua bërë shqiptarëvet jetën të padurueshme etj. deri atje sa këta të detyroheshin të linin Kosovën, viset shqiptarë të Maqedonisë e të Malit të Zi dhe të emigronin në Turqi, në Shqipëri e gjetkë. (f.458)

+ (27 mars 1978, bisedë në Sarandë) Në këta materiale rekomandohej... edhe shfrytëzimi i fesë myslimane për t'i dërguar në Turqi shqiptarët e këtij besimi, që, sipas sërbbomëdhenjvet, ishin një popull „*rebel*“ dhe qëndronin si pykë midis Sërbisë dhe Maqedonisë. Ata bënë plane që me largimin e shqiptarëvet nga toka e Kosovës, këta vende t'i popullonin me sërbbë e malazezë. (f.459)

+ (27 mars 1978, bisedë në Sarandë) Një nga ata që ka shkruar kështu, është njëfarë Çubrilloviq, që u bë më vonë anëtar i Lidhjes së Komunistëvet të Jugosllavisë, bile edhe ministër i qeverisë së Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë. E pra, politika e poshtër shoviniste, si e Jugosllavisë së vjetër, edhe e kësaj të sotmes, është e njëjlojtë. (f.459)

### ENVER HOXHA, **vepra 66.**

+ (11maj 1978, shënime) Në vendet revizionistë, psh., në Jugosllavinë titiste, po i jepet një shtytje e fortë zhvillimit të fesë. Bile në kufirin tonë verilindor, në Kosovë e në Maqedoni, jugosllavët po ngrenë xhami e faltore të reja. Përse i bëjnë ata këto? Së pari, për të mbajtur në errësi shqiptarët e atjeshëm, por edhe për të mbajtur gjithashtu gjallë e për t'i aktivizuar mbeturinat fetare edhe në këtë anë të kufirit. (f.194)

+ (20 maj 1978, shënime) Vallja me motive kosovarë, muzika e së cilës qe përpunuar nga Agim Krajka dhe që ishte vënë në skenë nga koreografi Besim Zekthi, na bëri gjithashtu përshtypje të madhe për bukurinë e për harmoninë e saj si dhe për kërcimin madhështor, për thjeshtësinë dhe burrërinë e vëllezërvet dhe motravet tona kosovare që vuajnë në Jugosllavinë titiste e ku e kanë aq vështirë të zhvillojnë artin dhe muzikën shqiptare... Shqipëria Socialiste i zhvillon motivet e Kosovës. Ata ne na prekin të gjithë dhe na bëjnë të mendojmë për ata vëllezër e motra që kanë luftuar për lirinë e pavarësinë e kombit tonë dhe vazhdojnë të luftojnë për të

fituar të drejtat e tyre kundër komplotistëve, intrigantëve e shovinistëve sërbë e titistëve jugosllavë. (f.218-219)

+ (25 maj 1978, *Të ruajmë thesarin e kombit*) Motrat dhe vëllezërit tanë në Kosovë entuziazmohen, qajnë dhe mallëngjehen, kur dëgjojnë dhe shohin në skenat e tyre artistët tanë që rrojnë në atdheun e lirë socialist. (f.279-280)

+ (27 maj 1978, *Patriotët e mëdhenj...*) Lidhja Shqiptare e Prizrenit, siç e dimë, është një nga ngjarjet më të shënuara e më të lavdishme të historisë së popullit tonë. 100 vjet më parë gjithë populli shqiptar, nga skaji më i largët i Kosovës, nga krahinat veriore e veriperndimore të Grudës e të Hotit e deri në Jugun ekstrem, në Çamëri, u ngrit në këmbë për një çështje të madhe, për unitetin e kombit shqiptar. (f.281-282)

+ (27 maj 1978, *Patriotët e mëdhenj...*) Në kuvendin që u mbajt në Gjirokastrë në korrik 1880 Abdyl Frashëri hodhi parullën për formimin e qeverisë shqiptare. Kjo platformë u pranua edhe nga Kuvendi i Dibrës në tetor 1880... (f.283)

+ (27 maj 1978, *Patriotët e mëdhenj...*) Stambolli... dërgoi në Shqipëri Dervishpashën me një ushtri të madhe. U zhvilluan kështu luftime të ashpër në Kosovë, në Dibër, në malësitë e Shkodrës. (f.283)

+ (27 maj 1978, *Patriotët e mëdhenj...*) Populli shqiptar, kudo ku ndodhet, në Shqipërinë e lirë socialiste, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e gjetkë, asnjëherë nuk e ka shuar patriotizmin e tij të zjarrtë, (frymëzimin) e tij të pashuar për atdheun, përkundrazi, ky patriotizëm ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. (f.284)

+ (10 qershor 1978, shënime) Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ishte vetëm një mbledhje krerësh. Ajo përfaqësonte vullnetin e gjithë kombit shqiptar, që nga skaji i Jugut deri në Mitrovicë e Kaçanik, në Plavë, në Guci e Tivar. Krerët e saj ishin bij të popullit, me mendje të madhe dhe me një kurajë të hekurt, që kishin një qartësi të madhe ideologjike, politike dhe ushtarake për kompaktësinë e kombit shqiptar e të trojevet të tij që rrëzikoreshin të copëtoreshin nga armiqtë e huaj shovinistë. (f.354)

+ (10 qershor 1978, shënime) Ata nuk u kufizuan në memorandume shterpë drejtuar Kongresit të Berlinit ose fuqivet të mëdha, por këta memorandume i shoqëruan me një mobilizim të madh e të gjithanshëm të masave të popullit shqiptar në Kosovë,

në Maqedoni, në Grudë dhe Hot, në Tivar, në Jug e kudo. Po kështu, edhe aksione luftarakë, me një propagandë e me një agjitacion të thellë e të zjarrtë. (f.354)

+ (10 qershor 1978, shënime) Lidhja Shqiptare e Prizrenit u bë epiqendra e luftës çlirimtare, ajo vuri në dukje lakmitë e sërbo-mëdhenjvet, të shovinistëve malazezë e grekë. Të gjithë këta, sidoms sllavët, i ndihmonte carizmi rus që luftonte për pansllavizmin, për bashkimin e gjithë sllavëve, për të dalë në Mesdhe dhe në Adriatik. (f.354-355)

+ (10 qershor 1978, shënime) Çështjen e Orientit historianët e borgjezisë e kanë shkruar sipas qejfit të tyre dhe Shqipërinë e kanë paraqitur në këtë çështje si një monedhë tregu për të plotësuar dëshirat e carit rus, të carit sërb, të car Nikollës së Malit të Zi dhe të mbretërve të Greqisë, kurse popullin shqiptar, që ishte një popull i gjallë, me kulturë, me gjuhën dhe me shkollat e tija, një popull që kishte luftuar në shekuj dhe vazhdonte të luftonte, ata e harruan dhe nuk e përmendin në librat e tyre. (f.355)

+ (10 qershor 1978, shënime) Shovinistët, cilëto qofshin këta, me çfarëdo petku që të vishen dhe me çfarëdo ideologjie që të mbulohen, çështjen e madhe të popullit shqiptar nuk do të mund ta shuajnë dot kurrë; ajo çdo ditë që kalon po forcohet dhe rrënjohet në zemrat e shqiptarëve, kudo që janë. Sidomos patriotizmi i vëllezërve tanë të Kosovës, të Dibrës, të Gostivarit, të Tivarit, të Ulqinit, të Plavës e të Gucisë, do të qëndrojë kurdoherë i ndezur për lirinë, për demokracinë, për kombin e tyre shqiptar. (f.355-356)

+ (10 qershor 1978, shënime) Disa tradhtarë me gjithë TANJUG-un, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e kanë katandisur në një luftë gjoja për alfabetin shqip, për shkollat e për pedagogjinë. Kjo është fare për të qeshur. Këta përpiqen të deformojnë historinë. Por ne nuk mund të presim ndonjë gjë të mirë nga armiqët tanë, veçse të deformojnë faktet, konkluzionet, rrjedhimet e kësaj lufte të madhe të popullit heroik të Kosovës dhe të të gjithë Shqipërisë. (f.356-357)

+ (13 qershor 1978, shënime) Gjatë Luftës Naciona-lirimtare ne nuk e shtruan çështjen nacionale në Kosovë dhe në viset e tjerë shqiptarë në Maqedoni dhe në Mal të Zi të Jugosllavisë së vjetër, të kralit sërb. Këtë për arsye se të dy popujt tanë qenë ngritur në luftë kundër të njëjtit armik. (f.379)

+ (13 qershor 1978, shënime) Në atë kohë nuk vihej aspak problemi i çështjes së popullsisë dhe i tokave shqiptare në Jugosllavi. Atëherë shtrohej problemi që të ngriheshin në luftë tok me ne kosovarët dhe shqiptarët e viseve tanë në Jugosllavi. Pastaj, në bazë të teorisë marksiste-leniniste dhe të zgjidhjes së drejtë të çështjes nacionale në shtetin jugosllav, i cili përbëhej nga shumë kombe, e drejta e vetëvendosjes duhej t'u jepej të gjithë kombeve e kombësive, në mes të cilëve edhe asaj shqiptare që përfshihej në shtetin jugosllav. Kështu vepruam ne në atë kohë dhe kjo është një rrugë e drejtë. (f.379-380)

**(*Nuk ka lis pa nyja e pa gunga.* Enver Hoxha, në atë kohë, duhej të kish vepruar ndryshe. Ai duhej ta shtronte problemin për një shtet të plotë shqiptar, në radhë të parë me aleatët anglo-amerikanë (duke u bërë atyre edhe koncesionet e domosdoshëm) dhe nëpërmjet tyre të merrej vesh edhe me udhëheqjen komuniste jugosllave. Gj.D.)**

+ (13 qershor 1978, shënime) Jugosllavët, edhe pse e quanin veten komunistë, dhe në atë kohë ne besonim se ishin të tillë, nën pretekstin se gjoja luftonin elementët ballistë, morën masa dhe vranë mjaft njerëz nga popullsia shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, po kështu edhe në Mal të Zi. (f.380)

+ (13 qershor 1978, shënime) Shikonim qëndrime e veprime që nuk na dukeshin shumë të drejtë, por këto ua vinim moskuptimeve ose sjelljes jokorrekte të individëve të ndryshëm dhe jo udhëheqjes jugosllave... Gjatë viteve 1947-1948, pikëpamjet antimarksiste, shoviniste... do të dilnin më qartë në dritë. (f.381)

+ (13 qershor 1978, shënime) Kur unë shkova për herë të parë në Jugosllavi, siç e kam shënuar edhe në shkrime të tjerë, në bisedën që pata me Titon, u ngrit edhe çështja e Kosovës dhe e të gjithë viseve shqiptare që i janë atashuar Jugosllavisë. Ai më pyeti mua cili ishte mendimi ynë për këtë problem. Iu përgjigja Titos se Kosova e viset e tjerë me popullsi shqiptare që i janë aneksuar Jugosllavisë (Sërbisë, Maqedonisë e Malit të Zi), janë toka shqiptare, të banuara nga shqiptarë, prandaj i përkasin Shqipërisë dhe tani që ne jemi dy vende socialistë, janë kushtet që ky problem të zgjidhet drejt. (f.381-382)

+ (13 qershor 1978, shënime) Titoja... pohoi se... këto toka dhe kjo popullsi i përkasin Republikës Popullore të Shqipërisë, por ju duhet të kuptoni, tha ai, se jemi akoma në fillim për konsolidimin e pushtetit tonë, prandaj, në rast se ne do të bëjmë një

gjë të tillë, domethënë, në rast se do t'ia kthejmë këta territore Shqipërisë, atëherë reaksioni sërb do të ngrejë krye dhe do të na dëmtojë në konsolidimin e pushtetit tonë popullor. (f.382)

+ (13 qershor 1978, shënime) Më pyeti nëse isha dakord kështu. Iu përgjigja se isha dakord, se kjo është zgjidhje e drejtë; ju njihni se këto janë toka shqiptare, i thashë, dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë dhe për këtë qëllim momentin duhet ta krijojmë. (f.382)

+ (13 qershor 1978, shënime) Më vonë u kuptua se ai ishte një shovinist, një element antimarksist dhe antishqiptar. Qëllimi i tij nuk ishte t'i jepte Shqipërisë tokat e grabitura nga Sërbia, nga Maqedonia e Mali i Zi, por ta fuste edhe vetë Shqipërinë në Federatën Jugosllave si një republikë të shtatë. (f.383)

+ (13 qershor 1978, shënime) I tillë ishte qëndrimi ynë pas Çlirimit për këtë problem dhe jam i bindur se ky qëndrim nga ana jonë ishte i drejtë. (f.383)

**(Jo, nuk ishte qëndrim i drejtë, por *nuk ka lis pa nyja e pa qunga*. Gj.D.)**

+ (13 qershor 1978, shënime) Qëndrimi ynë ka qenë dhe është që vëllezërit tanë që jetojnë në Jugosllavi, në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni, janë në vatrat e tyre, në tokat shqiptare. Këto toka janë grabitur nga sërbomëdhenjtë, nga malazezët, me ndihmën e fuqivet të mëdha imperialiste të asaj kohe. (f.383)

+ (13 qershor 1978, shënime) Ne nuk kemi dashur të hyjmë dhe nuk do të hyjmë në konflikt të armatosur për çështjen e bashkimit me mëmëdheun të trojevet shqiptarë nën Federatën Jugosllave. (f.383)

**(Duhej thënë: *Nuk e kemi parë të mundshme, sepse do ta humbisnim edhe këtë pjesë të Shqipërisë që me zor ia kishim shkëputur Konferencës së Londrës*. Gj.D.)**

+ (13 qershor 1978, shënime) Plani i sërbomëdhenjvet ishte që këtë etni shqiptare ta likuidonin, pse qëndronte si pykë në mbretërinë e tyre sërbo-kroate. Dhe titistët që ndiqnin po këta qëllime, për interesat e tyre shovinistë, këtë etni shqiptare, të lidhur ngushtë nga gjaku, nga traditat dhe nga gjuha, e ndanë në mes. Me një pjesë krijuan një krahinë gjoja autonome të Kosovës, kurse pjesën tjetër ia dhanë Maqedonisë për të krijuar kështu gjoja një shtet maqedonas. (f.384)

+ (13 qershor 1978, shënime) Morëm haptazi në mbrojtje edhe vëllezërit tanë shqiptarë që jetonin në Jugosllavi. (E) ngritëm fuqimisht zërin tonë kundër persekutimit, kundër gjenocidit, kërkuam që shqiptarët që jetojnë në trojet e vet në Jugosllavi të kishin shkollat e tyre, të kishin të drejtë të ruanin zakonet, këngët, kulturën shqiptare dhe unitetin e tyre etnik. (f.385)

+ (13 qershor 1978, shënime) Këto të drejta ne i mbrojtëm politikisht, pa bërë ndërhyrje të ndonjë lloji tjetër në këtë çështje... Mbrojtja që u bëmë ne vëllezërvet tanë shqiptarë në Jugosllavi pati efektet e saj. (f.385-386)

+ (13 qershor 1978, shënime) Përsa u përket marrëdhënievet tona me shqiptarët që jetojnë në tokat e tyre në Mal të Zi dhe në Maqedoni, mund të themi se titistët i kishin ngritur barrierat dhe vazhdonin t'i mbanin ato të ngritura kundër nesh, kundër kontaktevet tanë me vëllezërit shqiptarë në këto dy republika. (f.387)

+ (13 qershor 1978, shënime) Veçanërisht shqiptarët e Malit të Zi nuk kishin asnjë të drejtë as nga ato që gjoja fituan kosovarët në bazë të kushtetutës. Deri në vitet e fundit në Mal të Zi nuk kishte as shkollë për shqiptarët. (f.387-388)

+ (13 qershor 1978, shënime) Në Maqedoni popullsia shqiptare kishte disa të drejta, vetëm se rronte nën terrorin e egër të shovinistëvet maqedonas... Autoritetet maqedonas financohen nga Beogradi, u jepen para maqedonasvet që t'ua blejnë tokat shqiptarëvet, u ndërtojnë shtëpi dhe u krijojnë komoditete të veçantë, me qëllim që t'i forcojnë, arbitrarisht e artificialisht në dëm të shqiptarëvet. (f.388)

+ (13 qershor 1978, shënime) Sa ditë që të kalojnë, aq më tepër po zgjohet popullsia shqiptare që banon në tokat e veta në Jugosllavi. Kjo popullsi shqiptare, sidomos rinia që ruan traditat e vjetra të gjyshërvet e të stërgjyshërvet të saj, që ruan dashurinë e zjarrtë për mëmëdheun, për gjuhën e vet amtare, për të drejta të barabarta si komb, po zgjohet politikisht, po zgjohet ideologjikisht dhe shikon gjithnjë e më qartë greminën ku po shkon Jugosllavia e ku kërkon t'i tërheqë edhe shqiptarët. Prandaj te shqiptarët e Kosovës e të visevet të tjerë shqiptarë në Maqedoni dhe në Mal të Zi në forma të ndryshme rezistenca ka filluar të rritet. (f.388-389)

+ (13 qershor 1978, shënime) Ne kemi dërguar në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi grupet tanë teatralë, muzikorë, ansamble popullore me valltarë etj... Kemi disa vjet

që dërgojmë vazhdimisht profesorë të Universitetit të Tiranës për të dhënë leksione në Universitetin e Prishtinës. Titistët janë të detyruar ta bëjnë këtë lëshim nga vetë ekzistenca e një Shqipërie socialiste të fortë dhe nga zgjimi e nga forcimi i ndjenjave të unitetit të shqiptarëve, i ndjenjave të tyre patriotike, politike dhe ideologjike të shqiptarizmit, në Kosovë dhe në të gjithë viset e tjerë shqiptarë në Jugosllavi. (f.389-390)

+ (13 qershor 1978, shënime) Me efekt të madh janë edhe radioja e televizioni ynë, që dëgjohen e shikohen me etje të madhe nga të gjithë ata shqiptarë, në qytete bile edhe në fshatrat që kanë radio e televizorë. (f.390)

+ (13 qershor 1978, shënime) Nuk duhet të kemi besim tek ata për arsye se vazhdimisht kanë dashur dhe duan shkatërrimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, duan dobësimin dhe likuidimin e etnitetit të madh shqiptar në Jugosllavi, duan, gjithashtu, që Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë të shkatërrohen... Ata në mënyrë të fshehtë por shumë herë edhe të hapët, përpiqen që të përsëritet, në një shkallë akoma edhe më të madhe, historia e Traktatit të Paqes e Shën Stefanit dhe e Kongresit të Berlinit... Ambicjet dhe qëllimet grabitqarë e likuidatorë të fqinjëve tanë dhe të fuqivet të mëdha ndaj Shqipërisë nuk kanë ndryshuar. (f.390-391)

+ (13 qershor 1978, shënime) Aktualisht revizionistët kinezë janë në unitet të plotë me ata jugosllavë, për arsye se, si jugosllavët, edhe kinezët, kanë një pardon: Shtetet e Bashuar të Amerikës dhe kapitalin botëror. (f.392)

+ (13 qershor 1978, shënime) Ne duhet të parashikojmë se, pas vdekjes së Titos, në Jugosllavi do të lindin e do të zhvillohen probleme kapitalë. Përse? Sepse Jugosllavia është një burg popujsh. (f.393)

+ (13 qershor 1978, shënime) Dalja (e rusëve) në Ballkan ndesh në vështirësi, për arsye se NATO-ja, imperializmi amerikan dhe satelitët e tij, (po u bënë lëshime rusëve, Gj.D), duhet të nënshkruajnë vdekjen e vet... Vendi ynë vihet në rrëzik sulmi, si nga njëra palë, ashtu edhe nga tjetra... Ne do të gjendemi përballë armikut imperialist rus, të cilin duhet ta përballojmë... me forcat tona të unifikuara edhe me ato të vëllezërvet shqiptarë që jetojnë në Kosovë, në Mal të Zi e në Maqedoni. (f. (f.395)

+ (13 qershor 1978, shënime) Mësimi i madh i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, patriotizmi dhe zgjuarësia e udhëheqësve të saj, e prindërvet dhe e gjyshërvet tanë, nuk do të shkojnë kot. Shqipëria nuk do të gjendet kurrë më në ato pozita që u gjenden gjyshërit tanë... Këtë situatë, këta mendime, këto pikëpamje, ...duhet t'ua bëjmë të njohur, gjithashtu, edhe vëllezërvet tanë shqiptarë në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni dhe të gjithë shqiptarëvet kudo që jetojnë në botë. (f.396-397)

+ (13 qershor 1978, shënime) Burgjet, qoftë në Kosovë, qoftë në Serbi, janë plot me shqiptarë, kundër të cilëve, sipas lajmeve të gazetave të huaja, përdoren torturat... Studentët me kombësi shqiptare në Universitetin e Prishtinës dhe në përgjithësi gjithë rinia dhe nxënësit shqiptarë, kudo ku janë në Jugosllavi, qofshin në shkolla, qofshin në punë, ushqejnë dashuri të zjarrtë për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, e manifestojnë këtë dashuri dhe rezistojnë kundër masave shtypëse të autoriteteve serbe. (f.398-399)

+ (13 qershor 1978, shënime) Sërbët... nxitin në popullsinë shqiptare fenë myslimane, përpiqen për të gjetur libra, gazeta e broshura fetare, që t'i shpërndajnë nëpër Kosovë e në Maqedoni. Me këtë rrugë ata duan të shuajnë ndjenjat patriotike të kosovarëve dhe tek të gjithë shqiptarët në Jugosllavi. Shovinizmi serb i ka dhënë një rëndësi të madhe zhvillimit të ndjenjave fetare të shqiptarët. (f.399)

+ (13 qershor 1978, shënime) Në përkrahjen që ne duhet t'u japim vëllezërvet dhe motrave tona shqiptare në Jugosllavi, të kemi parasysh që të jemi të durueshëm... Duhet gjetur mënyrat, format, mjetet dhe të kihet shumë durim. Vetë kosovarët, vetë dibranët, gostivarasit, tetovarët e të tjerë, vetë shqiptarët në Mal të Zi, ta ndjejnë nevojën e edukimit patriotik dhe të gjejnë mjetet, mënyrat dhe format se si ta mbajnë gjallë, ta shumëzojnë dhe ta kalitin këtë sa më drejt. Ata vetë, duke u bazuar në atë pseudokushtetutë jugosllave, të mbrojnë e të kërkojnë që t'u plotësohen të drejtat që u takojnë. (f.400-401)

+ (13 qershor 1978, shënime) Në popull ka një fjalë të urtë që thotë: "***Ndihmo më parë veten, që të të ndihmojë (edhe) Zoti!***" (f.401)

## **Pasthënie:**



Vetëm atëherë kur të flitet pozitivisht për Enver Hoxhën në krejt botën, ka për t'u folur pozitivisht për të edhe në Shqipërinë zyrtare. Vetëm atëherë kur Enver Hoxhës do t'i ngrihen përmendoret në sheshet e qyteteve të botës, kanë për t'iu ringritur përmendoret edhe në Shqipërinë zyrtare.

A nuk u deshën 450 vjet që të përkthehej në shqip vepra e M.Barletit mbi Gjergj Kastriotin Skënderbeun, pasi ajo ishte përkthyer e botuar me dhjetëra herë thuajse në të gjitha gjuhët e Evropës?! A nuk qenë shkruar për të nëpër botë me qindra libra, para se ta shpallnim ne shqiptarët Gjergj Kastriotin Skënderbeun hero kombëtar?!

Kështu ka për të ndodhur edhe me Enver Hoxhën. Ka për ta pranuar më parë bota, pastaj Shqipëria zyrtare. Veçse nuk dihet a do të vlerësohet ky lider i Kombit Shqiptar (natyrisht, krahas K.Marksit, F.Engelsit, V.I.Leninit, J.V.Stalinit e të tjerë), para apo pasi Lufta e Tretë ta ketë përgjysmuar popullsinë e botës. Unë uroj që kjo njohje të ndodhë para SHKATËRRIMIT dhe pikërisht për ta PARANDALUAR katastrofën, të cilën vetëm të babëziturit nuk kanë sy dhe nuk e shohin.

Gj.D.